



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE  
PËR VITIN 2019**

**TË NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE STACIONI I AUTOBUSËVE  
SH.A PRISHTINË**

**Prishtinë, korrik 2020**

# 1 RAPORTI I AUDITORIT TË PËRGGJITHSHËM

Për: Komisionin Komunal të Aksionarëve;

Bordin e Drejtorëve të NPL Stacioni i Autobusëve sh.a Prishtinë z. Faton Raçi;

Kryeshefin Ekzekutiv z. Luan Hoti;

Zyrtarin Kryesor të Financave dhe Thesarit z. Arianit Grezda.

Adresa: Rr. Bill Klinton p.n, Prishtinë 10000, Kosovë

## 1.1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve sh.a Prishtinë

Ne kemi kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve sh.a Prishtinë (më tutje Stacioni i Autobusëve), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël.

## 2. Opinion i kualifikuar

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pozitës financiare të Stacionit të Autobusëve deri me 31 dhjetor 2019, performancës së saj, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2019, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Transaksionet janë kryer në pajtim me rregullat dhe rregulloret financiare, të aplikueshme për ndërmarrjet publike.

### Baza për opinion të kualifikuar

Ne kemi krijuar bazën për opinion të kualifikuar, për arsyen e përmendur në vijim:

1. Sipas SNK 1, një paketë e plotë e pasqyrave financiare ndër të tjera duhet të përmbajë informacione krahasuese të periudhave paraardhëse si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare duhet të prezantojnë informacionet shtesë të cilat nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë ose pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por që janë të rëndësishme për t'i kuptuar cilëndo prej tyre. Po ashtu me SNK 8, kërkohet që ndryshimet kontabël dhe korrigjimet e gabimeve të periudhave paraardhëse të kontabilizohen retrospektivisht.

Ndërmarrja në pasqyrën e pozitës financiare dhe pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet të vitit 2018 kishte mbivlerësuar kapitalin rezervë dhe pronën pajisjet dhe impiantet për 25,000€. Ne (ZKA) në raportin e auditimit për vitin paraprak kemi dhënë rekomandim për korrigjimin e nevojshëm të cilin ndërmarrja e kishte reflektuar në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por në pasqyrën e pozitës financiare kishte bërë korrigjimin vetëm për periudhën 2019 dhe jo për periudhën paraprake (2018) duke mos respektuar kërkesën e SNK për korrigjime retrospektive. Po ashtu të njëjtat korrigjime dhe shkaqet e tyre duhej të prezantoheshin në shënimet shpjeguese të pasqyrave, por ndërmarrja nuk kishte shpalosur informacionet e nevojshme për këto efekte të korrigjimeve.

### **Përgjegjësitë e menaxhmentit për Pasqyrat Vjetore Financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), dhe Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Menaxhmenti është po ashtu përgjegjës për kryerjen e transaksioneve financiare në pajtim me kornizën e aplikueshme ligjore.

**Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Stacionit të Autobusëve.**

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare janë në tërësi të lira nga keqdeklarimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe kështu të nxjerrim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdoherë keqdeklarimet materiale që ekzistojnë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Si pjesë e auditimit, në përputhje me SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticism të profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit

---

konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të Stacionit të Autobusëve.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruar të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e Stacionit të Autobusëve, për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Ne, gjithashtu i ofrojmë menaxhmentit deklaratën që ne i kemi zbatuar kërkesat përkatëse etike lidhur me pavarësinë, dhe iu komunikojmë atyre të gjitha marrëdhëniet dhe çështjet e tjera që në mënyrë të arsyeshme mund të mendohet se vënë në dyshim pavarësinë tonë, si dhe masat mbrojtëse, aty ku është e zbatueshme. Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin e auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

---

## 2 Gjetjet dhe Rekomandimet

Ne kemi kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Stacionit të Autobusëve për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit si dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të na mundësuar dhënien e opinionit për Pasqyrat Financiare Vjetore.

Lëndë të auditimit kanë qenë edhe efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe pajtueshmëria me kornizën ligjore dhe rregullative, por jo për qëllime të dhënies së opinionit.

Gjetjet dhe rekomandimet e përfshira në këtë pjesë kanë për qëllim përmirësimin e raportimit financiar dhe evitimin e dobësive në sistemin e kontrollit të brendshëm. Megjithatë, çështjet e ngritura në këtë raport nuk mund të konsiderohen si një pasqyrim i plotë i të gjitha dobësive që ekzistojnë ose të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen.

Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. Për detajet shih tabelën në shtojcën II.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Stacionit të Autobusëve gjatë zhvillimit të procesit të auditimit.

### 2.1 Rekomandimet për opinionin

**Rekomandimi A1**<sup>1</sup> Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë që PFV-të paraqesin një pamje të drejtë dhe të saktë dhe kurdoherë që kërkohen korrigjimet e nevojshme ato të reflektojnë edhe në periudhën retrospektive. Gjithashtu, në shënimet shpjeguese të PFV-ve të shpjegohen arsyet dhe efektet e korrigjimeve.

**Përgjigjja e menaxhmentit:** Pajtohet

---

<sup>1</sup> Çështja A dhe rekomandimi A-nënkuptojnë çështjet dhe rekomandimet e reja;  
Çështja B dhe rekomandimi B-nënkuptojnë çështjet dhe rekomandimet e përsëritura;  
Çështja C dhe rekomandimi C-nënkuptojnë çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

---

## 2.2 Gjetjet për çështjet e kontabilitetit dhe të pajtueshmërisë

### Çështja A2 - Mos prezantim i drejtë i zërave në pasqyrat financiare

- Kriteri** Sipas SNK 7, pasqyra e rrjedhës së parasë pika 20 sipas metodës së tërthortë, fluksi neto monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit përcaktohet duke rregulluar fitimin ose humbjen me efektet e: a) ndryshimeve gjatë periudhës në inventarët, në llogaritë e arkëtueshme dhe llogari të pagueshme të aktivitetit operativ, b) elementeve jo-mjete monetare si për shembull amortizimi, tatimet e shtyra, fitime dhe humbje neto të porealizuara nga monedhat e huaja, fitimet e pashpërndara të pjesëmarrjeve dhe interesat të pakicës. Për më tepër, SNK 1, duhet të zbatohet për të gjitha pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme që përgatiten dhe paraqiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit.
- Gjetja** Në evidencat kontabël, tek kartela llogaritja e humbjes së vitit ishte vlera 64,519€, ndërsa në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet ishte prezantuar vlera 63,080€, që rezulton me një diferencë prej 1,439€. Për të njëjtën vlerë zëri i fitimit të vitit në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet krahasuar me fitimin e vitit në pasqyrën e të ardhurave ishte nënvlerësuar. Për më tepër, ndërmarrja tek rrjedha e parasë nga aktivitetet operative, ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative kishte prezantuar vlerën 1,439€ (rritje/zvogëlim i humbjes nga viti 2017). Kjo vlerë kishte të bënte me rregullimin e një gabimi gjatë harmonizimit të kartelave mes ndërmarrjes dhe furnitorit. Kjo ka ndodhur nga pakujdesia gjatë hartimit të PFV-ve.
- Ndërmarrja në pasqyrën e rrjedhës së parasë në fund të vitit kishte prezantuar paratë në bankë dhe në arkë të mbivlerësuara për 988€, gjithashtu e njëjta vlerë ishte prezantuar e mbivlerësuar edhe në pasqyrën e pozitës financiare. Kjo sipas zyrtarëve të ndërmarrjes ishte për shkak që nuk kishin askush qasje në një nga llogaritë bankare të saj. Si rrjedhojë e mangësive të cekura më lartë për fitimin e vitit, paranë në bankë dhe në arkë, shënimet shpjeguese nuk japin informacione të plota dhe të sakta.
- Ndikimi** Prezantimi i zërit i cili nuk ka efekt financiar tek pasqyra e rrjedhës së parasë si dhe mbivlerësimi i parasë në bankë dhe në arkë ndikon në prezantim jo të drejtë dhe të saktë.
- Rekomandimi A2** Bordi i drejtorëve të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të prezantuar saktësisht secilin zë në pasqyra financiare dhe të konfirmoj që janë bërë korrigjimet e gabimeve të identifikuara tek gjendja e parasë dhe rrjedha e parasë sipas aktiviteteve operative.

**Përgjigjja e menaxhmentit:** Pajtohet

### **Çështja B1 - Prezantim jo i plotë i shënimeve shpjeguese**

- Kriteri** Sipas SNK1, shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Çdo zë në bilancin kontabël, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe në pasqyrën e fluksit monetar duhet të referohet me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese.
- Gjetja** Analiza e bërë për shënimet shpjeguese ka rezultuar që shpalosjet e bëra për fitimin e vitit dhe parave në bankë dhe në arkë nuk paraqesin një shpalosje të plotë dhe të saktë. Kjo ka ndodhur pasi që zyrtarët e ndërmarrjes nuk kanë qasje/autorizime në një nga llogari bankare të ndërmarrjes si dhe nga pakujdesia e zyrtarit i cili ka bërë përpilimin e shpalosjeve.
- Ndikimi** Mungesa e shpalosjeve të sakta, kufizojnë përdoruesit e pasqyrave për ta kuptuar drejt gjendjen financiare dhe afariste të ndërmarrjes.
- Rekomandimi B1** Kryesuesi i bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve, shënimet shpjeguese do të prezantojnë të gjitha informacionet e detajuara, të plota dhe të sakta për secilin zë në cilëndo pjesë të PFV-ve.

**Përgjigjja e menaxhmentit:** Pajtohet

---

**Çështja C1 - Mjetet e mbledhura nga bileta-shitësit depozitohen me vonesë**

**Kriteri** Sipas rregullores për paranë e gatshme-arka, neni 8, Likuidatorët janë të obliguar që të shkarkojnë dhe barazojnë porto arkat, të cilët me dokument intern e shkarkojnë porto arkën dhe e ngarkojnë arkën kryesore të NP-së. Po ashtu, neni 7 thekson se, arkëtari obligohet që para përfundimit të orarit të punës së paku deri në ora 15:00h, për secilën ditë të punës të dorëzoj paratë në xhirollogarinë e ndërmarrjes në njërin prej bankave komerciale që punojnë në Kosovë.

**Gjetja** Nga testimet e tetë (8) arkave ditore kemi vërejtur që bileta-shitësit ishin vonuar nga 1-7 ditë për t'i depozituar paratë në arkën kryesore dhe rrjedhimisht edhe në llogarinë bankare. Shuma e përbashkët e këtyre vonesave ishte 49,972€.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së mbikëqyrjes adekuate ndaj biletë-shitësve.

**Ndikimi** Mos depozitimi i mjeteve fillimisht në arkën kryesore e pastaj në llogarinë bankare me kohë, ndikon në rritjen e rrezikut që paratë të keqpërdoren ose të humbin.

**Rekomandimi C1** Bordi i drejtoreshave duhet të sigurojë që bileta-shitësit pasi ta përfundojnë orarin e punës t'i dorëzojnë mjetet në arkën kryesore e më pastaj të njëjtat të dorëzohen në llogarinë bankare.

**Përgjigjja e menaxhmentit:** Nuk pajtohet. Me gjerësisht shih Shtojcën 1, komentin 1.

**Pozicioni i Auditorit të Përgjithshëm:** Ndërmarrja ka dhënë vetëm arsyeime dhe përshkrim të situatës së konstatuar nga auditimi. Me gjerësisht shih përgjigjen tek Shtojca 1, komenti 1.



---

**Çështja B2 - Angazhimi i punëtorëve për punë dhe detyra specifike pa procedura të rekrutimit**

**Kriteri** Sipas Ligjit të Punës 03/L-212 nenit 8, punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpallë konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës.

**Gjetja** Stacioni i Autobusëve gjatë vitit 2019 kishte angazhuar 4 (katër) punëtorë me kontrata mbi vepër për punë dhe detyra specifike dhe me kohëzgjatje të caktuar në pozitat: 1 (një) zyrtar konsulent ligjor, 1 (një) zyrtar konsulent për financa, 1 (një) zyrtarë për mbarëvajtjen e procesit të programit të punës si dhe 1 (një) zyrtarë për financa, kontabilitet dhe këshillime tatimore. Për të gjitha këto angazhime, Stacioni i Autobusëve nuk ka shpallur konkurs publik.

Kjo ka ndodhur për shkak që menaxhmenti kishte shmangur kërkesat ligjore duke favorizuar kandidatët të cilët janë shpërblyer me këto kontrata.

**Ndikimi** Angazhimi i punonjësve për punë dhe detyra specifike pa zhvilluar ndonjë proces konkurrues dhe transparent ndikon në angazhimin e personave jo kompetent në pozita të caktuar.

**Rekomandimi B2** Bordi i drejtorëve të siguroj që me rastin e angazhimit të punonjësve të ri të zhvillohen procedura me konkurrencë të hapur dhe të respektohen të gjitha kërkesat për transparencë dhe përzgjedhje adekuate të kandidatëve.

**Përgjigjja e menaxhmentit:** Nuk pajtohet. Me gjerësisht shih Shtojcën 1, komentin 2.

**Pozicioni i Auditorit të Përgjithshëm:** Ndërmarrja ka dhënë vetëm arsyeime dhe përshkrim të situatës së konstatuar nga auditimi. Me gjerësisht shih përgjigjen tek Shtojca 1, komenti 2.

### Çështja A3 - Avancimi i punonjësit pa procedura transparente

- Kriteri** Sipas UA 07/2017, mbi rregullimin e procedurave të konkursit, neni 4 shpallja e vendeve të lira të punës duhet të jetë në përputhje me kushtet dhe kriteret e parapara me rregulloren e brendshme dhe aktet tjera në fuqi. Po ashtu pika 6 dhe 7 e këtij udhëzimi, parasheh që kompania duhet fillimisht të shpallë konkurs të brendshëm, nëse ka më shumë se një kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet e kërkuara për plotësimin e vendit të lirë të punës.
- Gjetja** Ndërmarrja në një (1) rast kishte avancuar punonjësin nga pozita e vozitësit në pozitën e punonjësit të logjistikës me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv duke anashkaluar procedurat e brendshme të shpalljes së konkursit për avancim në pozitë.
- Avancimi i punonjësit në pozitë pune pa ndjekur procesin e rregullt të avancimit ka ndodhur si rrjedhojë e mos-përfilljes së procedurave ligjore nga menaxhmenti i ndërmarrjes.
- Ndikimi** Anashkalimi i procedurave të rekrutimit (avancimit) paraqet mungesë të transparencës dhe ndikon në ulje të konkurrencës.
- Rekomandimi A3** Bordi i drejtorëve përmes Kryeshefit Ekzekutiv duhet të sigurojë se avancimi i punonjësve në pozita pune bëhet bazuar në përgatitjen adekuate profesionale, duke respektuar kërkesat ligjore mbi shpalljen e konkursit dhe mundësive të barabarta për të gjithë punonjësit.

**Përgjigja e menaxhmentit:** Pajtohet

**Çështja A4 - Pagesa e mjeteve financiare shtesë për punëtorin e angazhuar me kontratë mbi vepër**

**Kriteri** Sipas Ligjit të Punës, neni 10 pika 8 thekson se të punësuarit për një punë specifike nuk i takon e drejta në pushim vjetor dhe të drejtat tjera të përcaktuara me Kontratë Kolektive dhe Kontratën e punës.

**Gjetja** Ndërmarrja për periudhën e parë të vitit 2019 kishte punësuar me kontratë mbi vepër një (1) punonjës për të cilin, përveç kompensimit mujor ka marrë obligim sipas kontratës së lidhur, pika 2 që t'i paguaj edhe shpenzimet ditore të shujtës që është e paraparë sipas rregullores për punëtorët e rregullt të ndërmarrjes.

Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e neglizhencës apo mungesës së njohurive nga zyrtarët kompetentë mbi kërkesat dhe kufizimet ligjore.

**Ndikimi** Kompensimi shtesë me mjete financiare për punonjësit e angazhuar me kontratë mbi vepër shkakton mbi pagesa për vlerën e paguar për shujtë.

**Rekomandimi A4** Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë bërë korrigjimet e nevojshme që paraja e ndërmarrjes të shpenzohet në mënyrë të drejtë dhe në pajtim me kërkesat ligjore.

**Përgjigjja e menaxhmentit:** Pajtohet

---

## Çështja C2 - Mangësi në menaxhimin e pasurive

- Kriteri** Sipas Rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare, mjeteve themelore, asetëve të NPL-së, nenit 6.1, çdo organizatë duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël, si dhe neni 6.4 Zyrtari Kryesor Ekzekutiv duhet të themeloj regjistër kontabël të pasurive jo financiare ku përveç informatave të kërkuara nga Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, do të përfshihen edhe këto elemente: emri i ndërmarrjes publike, emri i pasurisë, përshkrimi, numri serik, numri i bar kodit, data e pranimit, lokacioni, kategoria, burimi i financimit, vlera fillestare ose e vlerësuar, zhvlerësimi i vitit të tanishëm dhe zhvlerësimi i akumuluar, vlera në libër, data e tjetërsimit, dhe numri referues i dokumentit të pranimit.
- Gjetja** Regjistri kontabël i pasurive nuk përmban të gjitha elementet e kërkuara si: datën e pranimit, vlerën fillestare, zhvlerësimin e vitit të tanishëm, zhvlerësimin e akumuluar dhe vlerën në libër.
- Ndërmarrja deri në kohën kur kemi përfunduar auditimin nuk kishte plotësuar pozitën për zyrtarin e pasurisë i cili do të ishte përgjegjës për menaxhimin dhe regjistrimin e pasurisë. Sipas zyrtarëve të ndërmarrjes, këtë funksion është duke e ushtruar një punonjës brenda ndërmarrjes. Mirëpo nuk ka ndonjë vendim i cili e fuqizon ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të zyrtarit të pasurisë.
- Ndikimi** Mos plotësimin i pozitës së zyrtarit të pasurisë si dhe regjistri i pasurive me informata jo të plota ndikon që pasuritë të mos trajtohen në mënyrën e duhur dhe rrjedhimisht të mos prezantohen saktë në pasqyrat financiare.
- Rekomandimi C2** Bordi i drejtorëve duhet të siguroj që në afat sa më të shkurtë kohor plotësohet pozita me zyrtarin e pasurisë si dhe regjistri i pasurive i përmban të gjitha informacionet për secilën pasuri sipas kërkesës së rregullores për menaxhimin e pasurive.

**Përgjigja e menaxhmentit:** Pajtohet

---

**Çështja A5 - Mungesa e raportit të komisionit për regjistrimin e mjeteve themelore, pajisjeve dhe inventarit**

- Kriteri** Sipas Ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, neni 12.1 kërkon që shoqëritë tregtare të verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit, dhe ky inventarizim duhet të barazohet me librat kontabël. Po ashtu, edhe rregullorja për menaxhimin e pasurive financiare neni 18 parasheh formimin e komisionit për inventarizimin e pasurive.
- Gjetja** Stacioni i Autobusëve në bazë të vendimit<sup>2</sup> të nxjerrë nga Kryeshefi ekzekutiv, kishte formuar komisionin për regjistrim të mjeteve themelore, (aseteve) pajisjeve inventarit dhe depos për vitin afarist 2019. Sipas vendimit ky komision është përgjegjës që të hartoj edhe një raport përfundimtarë mbi gjendjen e asetëve të ndërmarrjes. Mirëpo komisioni nuk kishte përgatitur një raport përmbledhës mbi verifikimin dhe gjendjen e pasurive të ndërmarrjes. Kjo për shkak të neglizhencës së komisionit për regjistrimin e mjeteve themelore.
- Ndikimi** Mos përgatitja e raportit përmbledhës për inventarizim e pasurive ndikon që ndërmarrja mos të ketë informata të gjendjes faktike të pasurive me regjistra kontabël dhe rrjedhimisht të pasojë me prezantime dhe shpalosje jo të sakta të pasqyrave financiare.
- Rekomandimi A5** Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se me rastin e inventarizimit të asetëve, anëtarët e komisioneve të jenë përgjegjës edhe në përgatitjen e raportit përmbledhës mbi gjendjen e pasurive themelore, pajisjeve dhe inventarit në mënyrë profesionale, objektive dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

**Përgjigjja e menaxhmentit:** Nuk pajtohet. Me gjerësisht shih Shtojcën 1, komentin 3.

**Pozicioni i Auditorit të Përgjithshëm:** Ndërmarrja ka dhënë vetëm arsyetime dhe përshkrim të situatës së konstatuar nga auditimi. Me gjerësisht shih përgjigjen tek Shtojca 1, komenti 3.

---

<sup>2</sup> Vendimi me Nr. 02/2402 të datës 23.12.2019 i nxjerrë nga Kryeshefi Ekzekutiv.

---

**Çështja C3 - Blerja e mallrave dhe shërbimeve pa procedura të prokurimit**

**Kriteri** Ndërmarrjet Publike me rastin e blerjeve të mallrave dhe shërbimeve kanë për obligim që të respektojnë të gjitha procedurat e Ligjit të Prokurimit Publik (LPP).

**Gjetja** Nga 17 pagesat e testuara ne kemi vërejtur se në nëntë (9) raste Stacioni i Autobusëve kishte bërë blerje direkt nga Operatori Ekonomik (OE) duke anashkaluar procedurat e prokurimit. Këto blerje ishin për shpenzime të telefonisë mobile<sup>3</sup>, furnizim me material zyrtarë, mirëmbajtja e sistemit të parkingut, shpenzime të përkthimit, shpenzime të ndriçimit dhe angazhimi i auditorit të jashtëm për konsulencë.

Këto blerje kanë ndodhur si rezultat i planifikimit të dobët dhe mosfunksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme në procesin e realizimit të blerjeve të mallrave dhe shërbimeve.

**Ndikimi** Blerja e mallrave dhe shërbimeve duke anashkaluar procedurat e prokurimit ndikon në kufizim të konkurrencës dhe mund të ndikojë në mos marrjen e vlerës për paranë e shpenzuar.

**Rekomandimi C3** Bordi i drejtoreshave duhet të sigurojë se në të gjitha rastet ku janë të aplikueshme të përdoren procedurat e prokurimit sipas kërkesave të LPP-së, duke shmangur blerjet direkte nga OE.

**Përgjigjja e menaxhmentit:** Nuk pajtohet. Me gjerësisht shih Shtojcën 1, komentin 4.

**Pozicioni i Auditorit të Përgjithshëm:** Ndërmarrja ka dhënë vetëm arsyetime dhe përshkrim të situatës së konstatuar nga auditimi, Me gjerësisht shih përgjigjen tek Shtojca 1, komenti 4.

---

<sup>3</sup> Kjo kontrate ishte lidhur në vitin 2017 por kishte pagesa në bazë të saj edhe në vitin 2019.

---

**Çështja B3 - Ndarje e tenderëve dhe mos aplikimi i procedurës së hapur të prokurimit**

**Kriteri** Neni 16.4 i LPP thekson se: Vlera e secilës kontratë duhet parashikuar dhe procedura e prokurimit përcaktohet konform vlerës. Autoriteti Kontraktues (AK) nuk do të ndajë kërkesën për prokurim për një sasi të caktuar të produkteve me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar në nenin 19 të këtij ligji “Çdo kontratë publike vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose me arsye pritet të jetë e barabartë me ose më e madhe se një mijë (1,000€), por më e vogël se dhjetë mijë (10,000€) konsiderohen ‘kontrata me vlerë të vogël’.

**Gjetja** Ne analizuam, raportin e kontratave me qëllim të vlerësimit nëse kishte ndarje të tenderëve për blerjen e artikujve të njëjtë dhe kemi vërejtur se AK kishte bërë ndarje të tenderëve duke përdorur procedurën e kuotimit me vlerë minimale ku kishte lidhur:

- Pesë (5) kontrata për furnizim me kompjuter, vlera e përbashkët e të cilave ishte 3,138€,
- Katër (4) kontrata për furnizim me uniforma për punonjësit e Stacionit të Autobusëve, vlera e përbashkët e të cilave ishte 3,423€,
- Pesë (5) kontrata për shërbime të printimit, vlera e përbashkët e të cilave ishte 4,192€.

Vlera e përgjithshme e kontratave kalon kufirin e caktuar për këtë procedurë. Sipas vlerës së kontratave AK për blerjen e këtyre artikujve ishte dashur të përdorë procedurën e hapur të prokurimit.

Përdorimi i procedurës së hapur e promovon konkurrencën duke i dhënë mundësinë që të ofertojnë një numër më i madh i OE. Ndarja e tenderëve ka ndodhur si rezultat i mungesës së planifikimit dhe funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme.

**Ndikimi** Ndarja e tenderëve dhe shmangia nga procedurat e hapura ndikojnë që ndërmarrja të mos arrijë të marrë vlerën për paranë e shpenzuar si dhe në kufizim të konkurrencës së mirëfilltë.

**Rekomandimi B3** Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet për një vlerësim dhe planifikim të nevojave të ndërmarrjes dhe artikujt e ngjashëm të grupohen dhe të përdoren procedurat e hapura të prokurimit, për të rritur konkurrencën dhe transparencën.

**Përgjigjja e menaxhmentit:** Pajtohet

---

**Çështja B4 - Mos plotësimi i pozitës me zyrtar të auditimit të brendshëm**

- Kriteri** Sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike neni 21.3 secila NP duhet të ketë një zyrtarë për auditim të brendshëm.
- Gjetja** Ndërmarrja edhe për kundër faktit që kishte shpallur konkurs për plotësimin e pozitës me zyrtarin për auditim të brendshëm, në mungesë të kandidatëve të interesuar nuk ishte e mundur të bëhet përzgjedhja e kandidatit të suksesshëm. Në fund të vitit 2019 përkatësisht në muajin nëntor është përsëritur konkursi, mirëpo deri në përfundim të vitit nuk ishte plotësuar kjo pozitë, respektivisht ishte plotësuar në prill të vitit 2020.
- Ndikimi** Mos plotësimi i pozitës së zyrtarit të auditimit të brendshëm ndikon që menaxhmenti të kenë vështirësi të kontrollojnë proceset dhe të detektojnë gabimet në mënyrë efektive dhe me kohë.
- Rekomandimi B4** Bordi i drejtoreve duhet të marrë masa adekuate për përzgjedhjen e zyrtarit të auditimit të brendshëm për të ndihmuar menaxhmentin lidhur me vlerësimin dhe identifikimin e dobësive të kontroleve të brendshme. Gjithashtu duhet të shqyrtohet mundësia që deri në plotësimin e pozitës, shërbimet e auditimit të brendshëm të sigurohen edhe nga aksionari.

**Përgjigjja e menaxhmentit:** Pajtohet



### 3 Çështjet e zgjidhura gjatë ciklit të auditimit

Ne gjithashtu gjetëm çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhën në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre.

#### Çështja A6 - Aprovime të pagesave pa autorizime adekuate

**Gjetja** Sipas Rregullores për menaxhimin dhe organizimin e punëve dhe detyrave në kontabilitet dhe financa neni 9, një dokument kontabël i cili shërben për regjistrim, duhet të përmbaj shënimet ndër të tjera nënshkrimin e personit të autorizuar për ligshmërinë dhe rregullsinë e ndodhjes së ndërrimit afarist (transaksionit ekonomik) dhe pagesës.

Nga testimet e bëra në fazën e ndërmjetme kemi vërejtur që nga 22 pagesat e testuara për blerje të pasurive, të mallrave dhe shërbimeve, janë identifikuar se pesë (5) prej tyre nuk ishin bërë autorizimet e nevojshme për aprovim të pagesës nga zyrtarët përgjegjës, ndërsa në pjesën e dytë të vitit nuk kishte pagesa të pa autorizuar nga zyrtari përgjegjës.

**Veprimi i kërkuar** Gjatë auditimit ishin ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për përgatitjen e formës për autorizimin/aprovimin e nevojshëm të pagesave dhe caktimin e zyrtarit certifikues.

**Rezultati** Menaxhmenti pas pranimit të Raportit të Auditimit<sup>4</sup> nga gjysma e dytë e vitit 2019 kishte autorizuar/aprovuar të gjitha pagesat nga zyrtarët përgjegjës.

<sup>4</sup> Për Pasqyrat Financiare vjetore për vitin 2018 të Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve sh.a Prishtinë, çështja A11- Mos plotësimi i pozitës me Zyrtarin Certifikues.

**Çështja A7 – Lëshimi i faturave nga ndërmarrja në emër të operatorëve transportues**

**Gjetja** SNK1, thekson se të pagueshmet tregtare dhe të pagueshmet tjera njihen në vlerën reale.

Ndërmarrja, për përmbushjen e obligimeve të saj me statut, kryen shërbime të ndryshme për operatorët transportues ku disa prej tyre për ndërmarrjen janë edhe llogari të arkëtueshme edhe llogari të pagueshme. Gjatë analizave të bëra kemi vërejtur se ndërmarrja për llogaritë e pagueshme ndaj operatorëve transportues kishte lëshuar vetë faturat në emër të operatorëve transportues e jo të njëjtat të lëshohen nga operatorët ekonomik. Saldo në fund të vitit për llogaritë e pagueshme ndaj operatorëve transportues ishte 5,952€.

**Veprimi i kërkuar** Gjatë auditimit i kemi rekomanduar menaxhmentit që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që faturimi të bëhet nga vet operatorët transportues.

**Rezultati** Menaxhmentin ka reaguar menjëherë dhe nga muaji janar 2020 e tutje faturimi bëhet vetëm nga ana e operatorëve transportues.

**Çështja A8 – Dobësi në faturim për lokalet në shfrytëzim të përkohshëm**

**Kriteri** Sipas rregullores, të nxjerrë nga BD me datë 26.01.2017, për dhënien e lokaleve afariste në shfrytëzim të përkohshëm (qiradhënie) dhe tokës, sipërfaqes për vendosjen e objekteve të përkohshme, neni 2 lokalet afariste në kuptim të kësaj rregullore konsiderohen: Lokalet afariste të zonës I dhe II ku janë të specifikuar sipërfaqja e lokalit në m<sup>2</sup>, terasës dhe sipërfaqja para lokalit. Po ashtu, neni 14 thekson që kontratat e reja eventuale do të jenë për kah përmbajtja të ngjashme me ato ekzistuese e me çmime ekuivalente sipas kategorive ekzistuese në këtë rregullore.

**Gjetja** Nga 100 mostrat e testuara në kategorinë e të hyrave, kemi identifikuar që:

- Në katër (4) raste kishte mbivlerësuar faturat për 632€ për lokalet të cilat ishin në shfrytëzim të përkohshëm;
- Në katër (4) rast nuk ishim në gjendje të kalkulojmë çmimin e lokaleve për qiratë pasi që lokalet nuk ishin të përfshira në rregullore dhe as në çmimoren e ndërmarrjes; dhe
- Për zona të njëjta të lokaleve kishte aplikuar çmime të ndryshme për m<sup>2</sup>, zonën I nga 2.27€ - 69€ dhe për zonën II nga 3.70€ - 21€.

Këto raste kishin ndodhur deri në nxjerrjen e rregullores së re dhe pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullorjeje nuk kemi vërejtur ndonjë rast të tillë.

**Veprimi i kërkuar** Në auditimin paraprak kemi rekomanduar Bordin e Drejtorëve që të marrin masa për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për dhënen e lokaleve

afariste në shfrytëzim të përkohshëm në mënyrë që të krijohen kushtet për aplikimin e tarifave të njëjta për zona të njëjta si dhe alikimin e çmimeve ekuivalente.

**Rezultati**

Gjatë vitit 2019 është bërë matja e hapsirave të lokaleve të lëshuara me qira dhe është bërë përcaktimi i vlerës së tyre nga një vlerësues i certifikuar i pronës. Në bazë të këtij vlerësimi është përpiluar rregullorja e re e cila ka hyrë në fuqi me 12 korriku 2019 dhe përmes të cilës janë eliminuar mangësitë e procesit të qiradhënies për kontratat e reja. Kontratat e nënshkruara më herët por që janë ende në fuqi (të cilat janë pëshkruar në këtë gjetje) nuk janë përmirësuar përmes hyrjes në fuqi të rregullores së re, për shkak të dëmeve eventuale që mund të shkaktojë shkëputja e njëanshme e kontratave me qiramarrësit ekzistues.

Nënshkruar nga:

  
\_\_\_\_\_

Besnik Osmani

Auditor i Përgjithshëm

Data: 24.07.2020

Zyra Kombëtare e Auditimit

Adresa: Rr. Ahmet Krasniqi, 210

Prishtinë, Kosovë

NAP/ Drejtori/UE

  
\_\_\_\_\_

Arvita Zyferi

  
\_\_\_\_\_

Enver Bouqlli

  
\_\_\_\_\_

Liridona Berisha - Kelmendi

Shtojca I: Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit<sup>1</sup>

Të gjeturat/ çështjet	Pajtohe mi po/jo	Komentet e NP-së në rast të mospajtitimit	Pikëpamjet e ZKA-së
Çështja C1 -  Mjetet e mbledhura nga bileta-shitësit depozitohen me vonesë.	Jo	<p>NPL "Stacioni i Autobuseve" sh.a. operon me orar të punës nga ora 04:00 deri në orën 24:00. Orari i punës së biletashitësve është i organizuar në tri (3) ndërrime:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Orari i parë: 04-10;</li> <li>2) Orari i dytë: 10-17;</li> <li>3) Orari i tretë: 17-24.</li> </ol> <p>Ndërsa në anën tjetër Arka kryesore punon vetëm me dy ndërrime prej orës 08 - 18</p> <p>Për këtë arsye vetëm mjetet e ndërrimit të fundit ngelin në arkë të biletashitësve dhe arka mbetet e mbyllur deri në ndërrimin e radhës. Bazuar në faktin që NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. është 21 orë nën mbikëqyrje të shërbimit policor dhe vlera e mjeteve në baza vjetore, është 49,972€ që i bie që në baza ditore është 137 euro, shumë për periudhën njëvjeçare për të cilën flitet si gjetje e auditorëve.</p> <p>Pra sasinë e mjeteve në fjale, NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. nuk e ka konsideruar si rrezik të humbjes apo keqpërdorimit të mjeteve. Po ashtu edhe gjatë auditimit të ZKA nuk është evidentuar asnjë humbje apo keqpërdorim të këtyre mjeteve.</p> <p>Për më shumë, për të qenë në pajtueshmëri me rekomandimin e auditorëve, NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. për të evituar çdo humbje apo keqpërdorim të mundshëm në të ardhmen menjëherë do të organizojmë një planifikim të orarit të ri i cili do të jetë në përputhshmëri me biletashitësve dhe arkën kryesore.</p> <p>NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. posedon një kontratë me kompaninë e sigurimit e cila bënë bartjen e mjeteve vetëm tri herë gjatë javës - dhe kjo është arsyeja pse mjetet deri më tani nuk janë depozituar në baza ditore në llogarinë bankare të NPL "Stacioni i Autobuseve" sh.a.</p> <p>NPL "Stacioni i Autobuseve" sh.a. do të rishikon kontratën me kompaninë e sigurimit që përveç tri ditëve të dorëzimit të mjeteve në banke në rast se tejkalohet limiti arkës të kontaktohet kompania për</p>	<p>Po i përmendim vetëm disa nga rastet e vonësive të dorëzimit të parave të mbledhura nga bileta-shitësit në arkën kryesore:</p> <p>Mjetet e mbledhura nga bileta-shitësi më 13.02.2019 të dorëzuar në bankë më 19.02.2019, vlera 1,046€;</p> <p>Mjetet e mbledhura nga bileta-shitësi më 08.05.2019 të dorëzuar në bankë më 13.05.2019, vlera 910.4€;</p> <p>Mjetet e mbledhura nga bileta-shitësi më 22.07.2019 të dorëzuar në bankë më 26.07.2019, vlera 1,064€;</p> <p>Mjetet e mbledhura nga bileta-shitësi më 14.08.2019 të dorëzuar në bankë më 19.08.2019, vlera 822€; si dhe disa raste tjera të ngjajshme.</p>

<sup>1</sup> Për korrektësi, komentet e NPL Stacioni i Autobusëve SH.A Prishtinë janë vendosur pa asnjë ndërhyrje.

		<p>dorëzim të mjeteve. Po ashtu do të jete edhe personi përgjegjës i cili do të monitoroj këtë limit në baza ditore dhe do të shtohet kontrolli në befasi nga mbikëqyrësi përgjegjës.</p>	<p>Andaj gjetja dhe rekomandimi i auditorit qëndron.</p>
<p>Çështja B2: Angazhimi i punëtorëve për punë dhe detyra specifike pa procedurë të rekrutimit</p>	<p>Jo</p>	<p>Ne lidhje me gjetjen e auditorit lidhur me çështjen B2 kjo është përgjigja e menaxhmentit:</p> <p>Ne fillim të vitit 2019, të gjitha pozitat e larta në kuadër të ndërmarrjes kanë qene me ushtrues detyre, të cilat sistemime apo ngritje në detyre janë bere nga ish anëtarët e bordit të drejtorëve të shkarkuar me vendim të komisionit të aksionarëve në Nëntor të vitit 2018. Pra këto lëvizje janë bere duke bere dhe anashkalim e ligjeve dhe rregullore të aplikueshme në fuqi, nga ish anëtarët e bordit të drejtorëve të shkarkuar.</p> <p>Ne përgjithësi të gjithë ushtruesit e detyrës të vendosur në pozita të larta kanë qene persona pa përvojë dhe pa ngritje profesionale adekuate, duke filluar nga UD KE, UD ZKFTH, UD. Sekretari Korporativ, ndërsa auditorja e brendshme edhe pse ka qene në detyre nuk ka bere asnjë veprim sipas Detyrimit Fiduciar me qëllim që ndërmarrja të aplikojë procedurat e ndryshme sipas rregulloreve dhe ligjeve të aplikueshme në fuqi.</p> <p>Të gjitha kontratat e përmendura janë bere sipas nevojës imediate nga Bordi i drejtorëve me qëllim që të vendosen proceset në vend me qëllim që ndërmarrja të fillon një rimëkëmbje të saj pas një keqmenaxhimi disa vjeçar. Krejt kjo ka ndodhe edhe për shkak të kohës së shkurte deri sa ndërmarrja ka filluar me procesin e rekrutimit të personave të lartë të cilët kanë qene me se të nevojshëm për ndërmarrjen.</p> <p>Të gjitha kontratat të cilat janë objekt i të gjeturës së auditorit janë në baze të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, për kryerjen e një pune intelektuale siç e parasheh ky Ligj, dhe jo në Baze të Ligjit të Punës, për një Punë dhe Detyra Specifike.</p> <p>Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, nuk parasheh ndonjë konkurs publik për rekrutim për një pune intelektuale. Kjo duhet të kuptohet qartë se nuk është krijim i marrëdhënies së punës.</p> <p>Mirëpo, edhe po që se Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, mbi bazën e të cilit kemi nënshkruar kontrata, do të mund të parashehte ndonjë procedure përkatëse, besoj që në si ndërmarrje nuk do të mund të zhvillonim, sepse në atë kohë nuk kemi pasur asnjë resurs njerëzor, që do të mund të zhvillonte procedurat apo intervistimet. Kjo ka qene edhe</p>	<p>Në Kosovë janë vetëm dy ligje që e rregullojnë marrëdhënien e punës: Ligji i punës dhe ligji për shërbyesit civil.</p> <p>Ligji për marrëdhënjet e detyrimeve, nëni 615 që i referohen kontratat në fjalë thotë: “Me kontratën për veprën kryerësi i punëve detyrohet të kryejë një punë të caktuar, sikurse është prodhimi ose riparimi i ndonjë sendi ose kryerja e ndonjë pune fizike ose intelektuale e të ngjashme kurse porositi është i detyruar për atë të paguajë shpërblimin”.</p> <p>Rastet të cilat në i referohemi në gjetjen tonë janë kontrata me afat mbi gjashtë muaj dhe për këta punëtorë janë paguar tatimet dhe kontributet pensionale nga punëdhënësi. Si të tilla të punësuarit në fjalë do të duhej të kontraktohen sipas procedurave të ligjit të punës dhe aktit të brendshëm të</p>

	<p>arsyeja e angazhimeve të bëra, sepse, po që se në si ndërmarrje do të kishim resurse njerëzore, nuk do të kishim nevojë për angazhim nga jashtë.</p> <p>Po që se ndërmarrja do të angazhonte nga jashtë, një person për Pune dhe Detyra Specifike, në baze të Ligjit të Punës, normalisht që do të duhej të zhvillonte procedura përkatëse, mirëpo edhe tek kjo çështje ndërmarrja nuk do të kishte mundur të zhvillonte një gjë të tillë, pasi që Udhëzimi Administrativ, përcakton qarte përbërjen e komisionit për zhvillimin e një procedure përkatëse, gjë që në atë kohe, pra në fillim të vitit 2019, ndërmarrja nuk ka pasur as Zyrtar Ligjor e as Sekretar në ndërmarrje, për të qene panel intervistues.</p> <p>Angazhimet e bëra me shume duhet të kuptohet, nëse e bëjmë një analogji, sikurse Ligji i Prokurimit Publik që parashihet procedura të negociimit (pa tender publik) kur është një situatë emergjente.</p> <p>Angazhimet e personave të caktuar, si p.sh. I konsulentit juridik ka qene kryesisht për hartimin e akteve të brendshme të ndërmarrjes dhe përfaqësimit në seanca gjyqësore dhe hartimin e shkresave gjyqësore (padi, përgjigje në padi etj), gjë që ndërmarrja nuk ka pasur punëtor me përvojë në këtë çështje, dhe mosveprimi i menjëhershëm në këto situata ka mundur të krijoj dëme të pa riparueshme materiale për ndërmarrjen.</p> <p>Angazhimet e bëra, duhet të shikohen dhe nga çështja e dobisë së ndërmarrjes. Menaxhmenti mendon me bindje të plote që këto kontrate me shume i kanë sjelle dobi ndërmarrjes, sesa ndonjë dem, kjo duke pasur parasysh dhe shumën e kompensimit.</p> <p>Vlen të theksohet fakti që menjëherë pas angazhimit të konsulentit ligjor, ai ka marrë pjesë në seanca gjyqësore dhe ka pranuar aktgjykime të ndryshme nga gjykatat, si dhe me ane të këshillave ligjore, ndërmarrja ka ndërmarre një sere veprimesh në organizim të punës brenda sajë , ku po që se do të bëhej angazhimi i konsulentit ligjor në baze të Ligjit të Punës dhe të zhvilloheshin procedura siç parashihet me Udhëzim Administrativ 07/2017, ndërmarrja kishte humbur afatet ligjore për veprim dhe demi material ndaj ndërmarrjes do të ishte me mijëra euro. Pra demi do të ishte me i lartë se sa dobia po që se do të aplikohet Ligji i Punës dhe do të zhvilloheshin procedurat sipas këtij ligji, në rastet konkrete. Gjithashtu, duhet të përmendet, as në aktet</p>	<p>punësimit dhe për kohën që e përcakton ligji i punës deri në 120 ditë për shkak se: P.sh kontrata për mirëmbajtje të serverit ishte nga 18 korrik 2019 deri me 18 janar 2020.</p> <p>Më tutje, kontrata për ekspert dhe konsulent të jashtëm ligjor, ishte nga 1 marsi deri me 01 shtator.</p> <p>Ndërsa kontrata "Ekspert i përgjithshëm dhe konsulent për financa të NP", në kontratë nëni 2 pika 2 thotë që: "Për të gjitha çështjet ku nevojitet ndihmë logjistike, kompensimi i shpensimeve të udhëtimit, shujta sipas rregullores, stazhi llogaritet sipas kontratës kolektive prej 0.5% dhe për çdo vit të punës së kaluar, të gjitha i bartë ndërmarrja". Pra, përmbajtja e kontratës është për të punësuar dhe jo për kontratë mbi vepër që do të mund hynin nën mandatin e ligjit për marrdheniet e detyrimeve.</p>
--	--	--

		<p>e brendshme te ndërmarrjes nuk parashihet ndonjë procedure përkatëse për një gjë te tille.</p> <p>Përfundimisht ritheksojmë me bindje te plote qe ne baze te Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, me te cilin kemi angazhuar konsulentë te jashtëm, nuk parashihen procedura te rekrutimit.</p>	<p>Andaj gjetja dhe rekomandimi i auditorit qëndron.</p>
Çështja A5: Mungesa e raportit të komisionit për regjistrimin e mjeteve themelore, pajisjeve dhe inventarit	Jo	<p>Ne bazë të Vendimit te Kryeshefit Ekzekutiv (KE) te NPL “Stacioni i Autobusëve” sh.a. është formuar komisioni për Inventarizimin e mjeteve themelore të NPL “Stacioni i Autobusëve” sh.a. Këtë Vendim KE e ka lëshuar me datën 23.12.2019, që sipas të gjitha gjasave, ky numërim i mjeteve (aseteve) do të zgjaste më së shumti deri dy ditë prej datës së vendimit të lëshuar.</p> <p>Në muajin shkurt 2020 gjatë procesit të auditimit, na është kërkuar dokumentacioni përkatës lidhur me inventarizimin e mjeteve themelore. Në atë kohë e kemi vërejtur se inventarizimi i mjeteve themelore nuk ka përfunduar, me pretekst se anëtari i komisionit gjatë kësaj kohe ka qenë i sëmurë dhe qe nuk ka mundur t’i shoh emërtimet e përshkruara me numra të inventarit.</p> <p>Edhe pse te gjithë anëtarët e komisionit e kane bere evidentimin e te gjithë inventarit, dhe kane bere nënshkrimin e dokumentit zyrtar, kjo gjetje është evidentuar, pasi që ligji e parasheh qe inventarizimi të përfundoj në tremujorin e fundit të vitit.</p>	<p>Menaxhmenti ka bërë përshkrimin e gjendjes së konstatuar nga auditimi dhe ka dhenë arsyet përse nuk është raportuar nga komisioni për regjistrimin e pajisjeve dhe të inventarit. Duke e pranuar gjetjen dhe duke mos e ofruar ndonjë argument ndryshe, gjetja dhe rekomandimi i auditorit mbeten të njëjta.</p>
Çështja C3: Blerja e mallrave dhe shërbimeve pa procedura të prokurimit	Jo	<p>Sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, dhe statutit te NPL “Stacioni i Autobusëve” sh.a. te gjitha vendimet merren nga Bordi i Drejtoreshave (BD) dhe ato pastaj ekzekutohen nga Kryeshefi Ekzekutiv (KE) i cili po ashtu është anëtare i BD-se.</p> <p>KE sipas vendimeve te BD-se si zyrtare kryesore ne emër te BD-se prezanton ndërmarrjen dhe e ka te drejtën te nënshkruajë kontrata, funksion është i parapare dhe i jep te drejte KE-se sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike dhe statutit te ndërmarrjes.</p> <p>Bazuar ne gjetjen “nga 17 pagesat e testuara është vërejte se ne nëntë (9) raste, NPL “Stacioni i Autobusëve” sh.a. kishte bere blerje direkte”, sipas analizimit te mostrave, e gjejmë se ne total janë 82 mostra te faturave te blerjes, te cilat janë audituar te cilat mund te vërtetohen sipas dokumenteve te dorëzuara si prove.</p> <p><u>Kontrata me IPKON</u> - Kjo është kontrate është lidhur me OE, “IPKO” ne vitin 2017, dhe ka pase vlefshmëri deri ne muajin Maj 2020. Kjo kontrate e gjate 24 muajshe ka qene si rezultatat i obligimeve te bëra nga ish menaxhmentit te cilat janë bere me blerjen e</p>	<p>Pretendimi i ndërmarrjes se janë testuar 82 mostra nuk qëndron, këto janë kartelat e furnitorëve në shënimet e kontabilitetit të ndërmarrjes. Ne nga kategoria e blerjeve të mallrave dhe shërbimeve kemi testuar 17 pagesa/mostra sëbashku me dëshmitë mbështetëse të tyre. Këto mostra i kemi dërguar përmes e-mail-it zyrtar tek personi ndërlidhës, të cilat</p>



	<p>telefonave mobil te mençur me çmime shume te larta, për anëtare te Bordit te Drejtoveve përfshire edhe ish KE-ne. Këto gjetje janë te përmendura edhe ne raportet e auditimit për vitin 2017 dhe 2018.</p> <p>Kjo kontrate është ndërprere, pas njoftimit lidhur me këtë kontrate nga menaxhmentit dhe pas përmbushjes se obligimit te SAP ndaj OE "IPKO", kane filluar procedurat e tenderimit te hapur publik sipas LPP, për angazhimin e OE te ri.</p> <p><b><u>Furnizim me material per zyre</u></b> - Si mostër është gjetur fatura nr. 250-200-001-19 lidhur me furnizim me material për zyre ne vlere prej 85.47 e cila është bere nga OE i cili ka pase kontrate valide për furnizim. Nëse është e gjetur qe është bere ndonjë porositje e cila nuk është ne kontrate atëherë përgjegjësia bie ne menaxherin e kontratës, dhe kërkuesin për furnizim. Ne rastin konkret përgjegjësia nuk bie tek Bordi i drejtoveve apo KE. Po ashtu vlere e këtij furnizimi është ne shumen me te vogël se 100 €, dhe sipas rregulloreve ne fuqi kjo vlere mund te paguhet me "Petty Cash".</p> <p><b><u>Mirëmbajtja e sistemit te parkingut</u></b> - NPL "Stacioni i i Autobusëve" sh.a. Prishtine, si ndërmarrjes shërbyese i krijon te hyrat nga shërbimi i peronizimit për autobusë dhe shërbimi i parkingut për vetura te ndryshme. Pra këto dy shërbime janë jetike për qëndrueshmërinë financiare te ndërmarrjes.</p> <p>Me ndryshimet e menaxhmentit te ndodhura ne fillim te vitit 2019, është vërtetuar qe ky shërbim nuk është duke u menaxhuar nga asnjë OE, dhe është vërtetuar qe është një nga te metat kryesore te hasura ne ndërmarrje, dhe është një nga burimet kryesore te keqpërdorimeve te mundshme me paranë publike.</p> <p>NPL "Stacioni i i Autobusëve" sh.a. Prishtine respektivisht menaxhmenti i kaluar ish KE ka nënshkruar kontrate me OE "PBC" shpk, me date 12.05.2017. Ne kuadër te kësaj kontrate është parapare mirëmbajtja një (1) vjeçare e sistemit te parkingut. Afati i dorëzimit te shërbimit ka qene 90 dite kalendarike pas nënshkrimit te kontratës. Pra sipas kësaj kontrate, obligimi i PBC-se ndaj NPL "Stacioni i i Autobusëve" sh.a. Prishtine, ka përfunduar me 12.08.2018.</p> <p>Ish ushtruesi i detyrës se KE-se, pas kësaj periudhe, pra pas 12.08.2018 ne mënyre te parregullt ka angazhuar disa here kompaninë ELEKTROSOFT nga Maqedonia Veriore për mirëmbajtje te sistemit te parkingut duke i anashkaluar procedurat e LPP-se.</p>	<p>janë pranuar dhe trajtuar nga ne.</p> <p>Neni 26 i ligjit të Prokurimit Publik, thotë: zyrtari përgjegjës i prokurimit i një autoriteti kontraktues është i vetmi person i autorizuar të lidhë ose të nënshkruajë një kontratë publike në emër të autoritetit të tillë kontraktues.</p> <p>Pra, kontratat me: Ipko-n, për furnizim me material për zyre dhe mirëmbajtja e sistemit të parkingut, ishin kontrata të cilat nuk ishin të lidhura sipas procedurave të Prokurimit, derisa këto blerje janë në fusheverpim të ligjit të Prokurimit Publik.</p> <p>Ndërsa blerja nen 100€ për nga shumat mund të bëhet me "Petty cash" por për nga lloji i blerjes blerja dhe ndarja e faturave nuk lejohet. Në këtë rast ishin bërë blerje të njëjta me tri fatura ne vlerë 246€ nga i njëjti OE.</p> <p>Nga mostrat e testuara për vitin</p>
--	---	---

	<p>Duke u ballafaquar me situatën momentale dhe të gjeturat në ndërmarrje, KE me rekomandim të anëtareve të bordit dhe aksionareve të ndërmarrjes ka kontaktuar kompaninë e cila në vitin 2015, ka qene e angazhuar për mirëmbajtjen e sistemit të parkingut të cilën gjë e ka bere deri në vitin 2017, kur kontrate i është ndërprere dhe kontrata i është dhëne OE "PBC" shpk, e cila kompani nuk i ka përmbushur të gjitha obligimet ende ndaj ndërmarrjes sipas kontratës në fjale.</p> <p>Me qëllim të funksionalizimit sa me të shpejte të këtij shërbimi jetik për ndërmarrjen, me qëllim të evitimit të keqpërdorimeve të mundshme të parasë publike pra dëmtimin e bugjetit të ndërmarrjes, KE me rekomandim të BD dhe Aksionareve ka hyre në negociim me kompaninë FARA, lidhur me angazhim sa me të shpejte me qëllim të funksionalizimit të sistemit të parkingut.</p> <p>Kontrata për shërbim e nënshkruar me date 15.04.2019, ka qene kontrate në formë të Grantit sipas praktikave të USAIDIT-it, ku OE "Fara" ka marrë për obligim të beje investimin e tërësishëm për funksionalizimin e sistemit të parkingut dhe në kundërvlere të investimit të behet pagesa mujore për shërbim, për një afat të caktuar kohor.</p> <p>Duke pasë parasysh që kjo kontrate e veçante e nënshkruar ka pasë për qëllim funksionalizimin e sistemit për një kohë sa me të shpejte, nuk është bere pagesa për shërbime mujore ndaj OE Fara, deri sa të merret një opinion i pavarur nga auditorët e pavarur, lidhur me kontratën në fjale dhe validetin e saj legal.</p> <p>Për këtë qëllim është angazhuar një kompani e pavarur e auditimit përmes procedurës së rregullt bazuar në LPP-se. Në baze të rekomandimit të auditorit të pavarur është bere shkëputja e kontratës ekzistuese me OE "FARA" e nënshkruar me 15.04.2019, dhe është iniciuar procedura e tenderimit publik për përzgjedhjen e operatorit i cili do të ofrojë shërbimin e kërkuar në baze të procedurave të LPP-se.</p> <p>Te gjitha pagesat lidhur me shërbimin e OE "FARA" për periudhën kur janë pranuar shërbimet sipas kontratës së nënshkruar me 15.04.2019, i janë bere në mënyre të rregullt duke mos lejuar që ndërmarrja të obligohet të beje pagesën e detyrueshëm përmes përbaruesve privat.</p> <p><b>Shpenzimet e përkthimit</b> - kjo kontrate është lidhur për shërbimet e përkthimit të ndërmarrjes. Është kontrate për punë specifike dhe për shkak të</p>	<p>2019 nuk kemi identifikuar ndonjë pagesë për elektrosoft.</p> <p>Kontrata e lidhur direkt me OE "Fara" mbulon periudhën 3 vjeçare dhe me një pages të rregullt mujore me 1,500€, e cila nuk ishte lidhur me procedura të prokurimit publik.</p> <p>Shërbimet e përkthimit ishin nga data 10 maj deri me 19 nëntor 2019 me 14 fatura</p>
--	---	--

	<p>urgjencës dhe natyrës se punës është bere ne mënyre direkt me pune kryesin. Sipas Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, lejohet angazhimi për kryerjen e një pune specifike – intelektuale.</p> <p>Ne do ti kemi parasysh rekomandimet e auditorit dhe këto veprime nuk do te përsëriten ne te ardhmen.</p> <p>Për vitin 2020, planifikohet shpallja e tenderit te hapur për aktivitetet e ngjashme.</p> <p><b>Shpenzimet te ndriçimit</b> – kjo e gjetur ka te beje me blerje specifike për ndriçim te ndërmarrjes. Është pagese prej 83,00 € dhe ne mendojmë qe nuk ka asnjë shkelje ne rastin konkret, bazuar ne proceduarat e LPP.-se.</p> <p><b>Angazhimi i auditorit te jashtme për konsulentë</b> – angazhimi i konsulentit te jashtëm është bere me vendim te bordit te drejtoreve ku i lejohet KE-se angazhimi me pagese i ndonjë personi te autorizuar apo auditori te jashtëm për vlerësimin e kontratave kontestuese te cilat janë te gjetura ne ndërmarrje.</p> <p>Edhe ne rastin konkret, si ne rastin e mëparshëm, sipas Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, lejohet angazhimi për kryerjen e një pune specifike intelektuale.</p>	<p>në shumë të përbashkët 630€, pra nuk ishin punë specifike dhe as urgjente siç thuhet nga SA.</p> <p>Për shërbimet e ndriçimit në bazë të kartelës së furnitorit, për 12 muaj ishin bërë blerje 17 herë me pagesa nën 100€, me vlerë të përbashkët 1,284€ nga i njëjti OE.</p> <p>Andaj gjetja dhe rekomandimi i auditorit qëndron.</p>
--	--	---

## Shtojca II: Statusi i zbatimit të rekomandimeve të vitit(eve) paraprak(e)

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2018 të Stacionit të Autobusëve ka rezultuar në 19 rekomandime kryesore. Ndërmarrja kishte përgatitur një Plan Veprimi ku është paraqitur mënyra e zbatimit të rekomandimeve të marra.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, nëntë (9) rekomandime janë zbatuar; tre (3) ishin në proces, gjashtë (6) nuk janë adresuar ende dhe një (1) ishte rekomandim i mbyllur i pa zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni me poshtë në Tabelën 1.

Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve për vitin 2018 dhe vitin 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që secili zë i pasqyrave financiare të paraqes vlerën e saktë dhe të mbështetur nga informatat e kontabilitetit të cilat janë të dokumentuara me dëshmi relevante dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.	Ndërmarrja nuk kishte bërë korigjimin e rekomandimit të auditimit në PFV-të e vitit 2019.	Rekomandim i pa zbatuar .
2	Plani i biznesit (të hyra dhe shpenzimet)	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që plani i biznesit bazohet në mundësitë reale të ndërmarrjes dhe realizimi i burimeve të financimit të monitorohet në mënyrë sistematike. Ndryshimet apo devijimet e mëdha nga plani fillestar duhet të reflektohen në një plan të rishikuar.	Ndërmarrja në planin e biznesit për vitin 2019-2020 kishte planifikim të ngjashëm me vitin e kaluar.	Rekomandim i mbyllur i pa zbatuar.
3	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që regjistri i pasurive i përmban të gjitha informacionet sipas kërkesës së rregullore për menaxhimin e pasurive, si dhe të siguroj se me rastin e largimit nga puna apo përfundimit të mandatit të stafit të saj bëhet shkarkimi nga pasuritë e shfrytëzuara. Të gjitha pasuritë të cilat i takojnë ndërmarrjes duhet të kthehen në ndërmarrje dhe të shfrytëzohen nga stafi aktual. Po ashtu duhet të bëhet përditësimi i rregullore për menaxhimin e pasurive duke përfshirë edhe pranim-dorëzimin e tyre.	Gjatë vitit 2019 është bërë kthimi i pasurive, ndërsa sa i përket regjistrin të pasurisë ende nuk i përmban të gjitha elementet e kërkuara.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
4	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se paraja e ndërmarrjes po shpenzohet në mënyrë të drejtë, duke i kushtuar prioritet pagesave të obligimeve tjera të ndërmarrjes. Gjithashtu bonuset dhe shpërblimet tjera të mos jepen derisa ndërmarrja është duke operuar me humbje.	Gjatë auditimit të vitit 2019, nuk janë dhënë shpërblime/ bonuse për punonjësit.	Rekomandim i zbatuar.
5	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që me rastin e angazhimeve të punonjësve të ri të zhvillohen procedura me konkurrencë të hapur dhe të respektohen të gjitha kërkesat për transparencë dhe përzgjedhje adekuate të kandidatëve.	Gjatë auditimit të vitit 2019, ne kemi verifikuar se për këtë vit nuk ishin zhvilluar procedura të rekrutimit me rastin e angazhimit të	Rekomandim i pa zbatuar.

			punonjësve me detyra specifike.	
6	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se të gjitha vendimet e ndërmarrjes merren në pajtueshmëri me aktet dhe rregulloret në fuqi.	Ndërmarrja kishte miratuar rregulloren për sistematizimin e punëtoreve.	Rekomandim i zbatuar.
7	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se sistemimi i punonjësve nëpër pozitat e punës bëhet duke u bazuar në përgatitjen adekuate profesionale, dhe duke i respektuar kërkesat e rregullores për organizim të brendshëm.	Ndërmarrja kishte miratuar rregulloren për sistematizimin e punëtoreve.	Rekomandim i zbatuar.
8	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që faturimi bëhet sipas tarifave të zonave respektive dhe në rastet kur janë aplikuar tarifa të ndryshme për zona të njëjta të lokaleve të merren masa korrigjuese duke mundësuar aplikim dhe trajtim me çmime ekuivalente dhe në pajtim me rregulloren.	Gjatë auditimit kemi identifikuar dukurinë e njëjtë.	Rekomandim i pa zbatuar.
9	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që me të gjithë operatorët për të cilët kryhen shërbime të lidhen kontrata ku do të specifikoheshin të drejtat dhe detyrimet e palëve	Gjatë auditimit nuk kemi identifikuar parregullsi të njëjtë.	Rekomandim i zbatuar.
10	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që rregullorja aktuale e cila është duke u aplikuar të rishikohet dhe të përfshijë të gjitha llojet e të hyrave mbi të cilat ndërmarrja ka të drejta dhe detyrime.	Stacioni i Autobusëve ka rishikuar statutin e saj dhe ka përfshirë aktivitetet të cilat i lejohet të realizoj.	Rekomandim i zbatuar.
11	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që faturimi për obligimet komunale për lokalet të cilat janë dhënë në shfrytëzim të përkohshëm të bëhet drejtpërdrejtë te qiramarrësit, në mënyrë që të shmangët rritja e llogarive të arkëtueshme dhe dëmtimi financiar i ndërmarrjes.	Nga viti 2019 e tutje ndërmarrjet komunale i kryejnë faturimet për shërbimet e tyre.	Rekomandim i zbatuar.
12	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se është bërë një vlerësim dhe planifikim i nevojave të ndërmarrjes ku artikujt e ngjashëm grupohen për tu blerë përmes një procedure të vetme, si dhe për blerjen e tyre aplikohen rregullat e prokurimit sipas kërkesave të LPP-së.	Nga mostrat e testuara kemi vërejtur që ndërmarrja ende bën blerje pa procedura të prokurimit.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.

13	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet për një vlerësim dhe planifikim të nevojave të ndërmarrjes, ndërsa artikujt e ngjashëm të grupohen dhe të përdoren procedurat e prokurimit sipas kërkesave të LPP-së, duke shmangur ndarjen e tenderëve në disa pjesë.	Ndërmarrja edhe gjatë vitit 2019 kishte bërë blerje pa procedura të prokurimit.	Rekomandim i pa zbatuar.
14	Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme	Kryesuesi i Bordi duhet të sigurojë që brenda një afati të shkurtë kohor të hartojë një rregullore të brendshme për menaxhimin e arkës ku do të përshkruheshin të gjitha procedurat standarde. Po ashtu, të siguroj që biletë-shitësit pasi ta përfundojnë orarin e punës t'i dorëzojnë mjetet në arkën kryesore e më pastaj të njëjtat të dorëzohen në llogarinë bankare.	Ndërmarrja kishte aprovuar rregulloren e arkës, ndërsa sa i përket vonesave të dorëzimit të mjeteve në arkën kryesore pastaj në llogarinë bankare, ende jo.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
15	Trajtimi i shënimeve shpjeguese	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve, shënimet shpjeguese do të prezantojnë të gjitha informacionet e detajuara, të plota dhe të sakta për secilin zë që përmbajnë shuma të grumbulluara në cilëndo pjesë të PFV-ve.	Shpalesjet e bëra për PVF-të e 2019 nuk paraqesin pamjen e drejtë.	Rekomandim i pa zbatuar.
16	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që përmes Komisionit të Auditimit të bëhet funksionalizimi i NJAB-së si dhe të rishikohet në mënyrë kritike plani i auditimit të brendshëm. Më tutje, Komisioni i Auditimit fillimisht duhet të bëjë miratimin e planit e pastaj në mënyrë të vazhdueshme edhe mbikëqyrjen e përmbushjes së tij.	Gjatë vitit 2019 ndërmarrja nuk kishte arritur ta plotësoj pozitën e AB, pas skadimit të kontratës së AB.	Rekomandim i pa zbatuar.
17	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryesuesi i Bordit duhet të bëjë një ristrukturim të stafit për plotësimin e pozitës së zyrtarit certifikues, ose të lidhë marrëveshje me organizatën kontrolluese buxhetore (aksionarin) për ndarjen e shërbimeve të një zyrtari të vetëm certifikues, për të siguruar kontrolle efektive në procedimin e pagesave.	Ndërmarrja kishte bërë plotësimin e pozitës me zyrtarin certifikues.	Rekomandim i zbatuar.
18	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar të protokollohen në datën e pranimit të tyre, në mënyrë që të mund të maten vonesat për pagesa, të shmangen ndëshkimet për vonesa të pagesave dhe të menaxhohen më mirë obligimet e ndërmarrjes.	Gjatë auditimi nuk kemi hasur ndonjë faturë të pa protokolluar.	Rekomandim i zbatuar.

19	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj hartimin e planit për menaxhimin e rreziqeve, të delegoj përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës, të siguroj raportim mujor për zbatimin e kërkesave ndaj rreziqeve duke përfshirë vlerësimin e ndikimit të tyre në rast se ato ndodhin, si dhe të përcaktoj masat parandaluese dhe përgjigjet ndaj tyre.	Ndërmarrja kishte bërë monitorimin e listës së rreziqeve.	Rekomandim i zbatuar.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	PFV	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë që PFV-të paraqesin një pamje të drejtë dhe të saktë dhe kurdoherë që kërkohen korrigjimet e nevojshme ato të reflektojnë edhe në periudhën retrospektive. Gjithashtu, në shënimet shpjeguese të PFV-ve të shpjegohen arsyet dhe efektet e korrigjimeve.		
2	PFV	Bordi i drejtorëve duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve, shënimet shpjeguese do të prezantojnë të gjitha informacionet e detajuara, të plota dhe të sakta për secilin zë në cilëndo pjesë të PFV-ve.		
3	PFV	Bordi i drejtorëve të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të prezantuar saktësisht secilin zë në pasqyra financiare dhe të konfirmoj që janë bërë korrigjimet e gabimeve të identifikuar tek gjendja e parasë dhe rrjedha e parasë sipas aktivitetëve operative.		
4	Të hyra	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë që bileta-shitësit pasi ta përfundojnë orarin e punës t'i dorëzojnë mjetet në arkën kryesore e më pastaj të njëjtat të dorëzohen në llogarinë bankare.		
5	Shpenzime	Bordi i drejtorëve të siguroj që me rastin e angazhimit të punonjësve të ri të zhvillohen procedura me konkurrencë të hapur dhe të respektohen të gjitha kërkesat për transparencë dhe përzgjedhje adekuate të kandidatëve.		
6	Shpenzime	Bordi i drejtorëve përmes Kryeshefit Ekzekutiv duhet të sigurojë se avancimi i punonjësve në pozita pune bëhet bazuar në përgatitjen adekuate profesionale, duke respektuar kërkesat ligjore mbi shpalljen e konkursit dhe mundësive të barabarta për të gjithë punonjësit.		
7	Shpenzime	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë bërë korrigjimet e nevojshme që paraja e ndërmarrjes të shpenzohet në mënyrë të drejtë dhe në pajtim me kërkesat ligjore.		
8	Pasuri	Bordi i drejtorëve duhet të siguroj që në afat sa më të shkurtë kohor plotësohet pozita me zyrtarin e pasurisë si dhe regjistri i pasurive i përmban të gjitha informacionet për secilën pasuri sipas kërkesës së rregullore për menaxhimin e pasurive.		
9	Pasuri	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se me rastin e inventarizimit të aseteve, anëtarët e komisioneve të jenë përgjegjës edhe në përgatitjen e raportit përmbledhës mbi gjendjen e pasurive themelore, pajisjeve dhe inventarit në mënyrë profesionale, objektive dhe në përputhje me dispozitat ligjore.		



---

10	Prokurim	Bordi i drejtoreve duhet të sigurojë se në të gjitha rastet ku janë të aplikueshme të përdoren procedurat e prokurimit sipas kërkesave të LPP-së, duke shmangur blerjet direkte nga OE.
11	Prokurim	Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet për një vlerësim dhe planifikim të nevojave të ndërmarrjes dhe artikujt e ngjashëm të grupohen dhe të përdoren procedurat e hapura të prokurimit, për të rritur konkurrencën dhe transparencën.
12	Auditim i brendshëm	Bordi i drejtoreve duhet të marrë masa adekuate për përzgjedhjen e zyrtarit të auditimit të brendshëm për të ndihmuar menaxhmentin lidhur me vlerësimin dhe identifikimin e dobësive të kontrolleve të brendshme. Gjithashtu duhet të shqyrtohet mundësia që deri në plotësimin e pozitës, shërbimet e auditimit të brendshëm të sigurohen edhe nga aksionari.

## Shtojca III: Letër Konfirmimi



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH. A. PRISHTINË  
G.J.P "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA  
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2019 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Financiare të Stacionit të Autobusëve sh.a Prishtinë për vitin 2019 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe përmbajtjen e Raportit, përveç çështjes A1,C1, B2, A5 dhe C3;

Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Faton Raçi

Kryesuese e Bordit të Drejtorëve,

Data: 22. korrik 2020, Prishtinë.



## Shtojca IV: Pasqyrat Financiare Vjetore të Audituarra



NPL"Stacioni I Autobusëve"Sh.A,Prishtinë  
 NRF:600118245  
 NU: 811318741

INFORMATION AUTOBUS STATION  
 GPS COORDINATES: 43° 54' 15.00" N  
 21° 01' 20.00" E  
 PRISHTINE

Pasqyra e pozitës financiare më 31 dhjetor 2019

	Shënim	2019 €	2018 €
<b>I PASURITË</b>			
1 Pasuritë afatshkurtra			
2 Paraja dhe ekuivalentët e parasë	6	135,579	151,818
3 Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	7	53,891	62,243
4 Stoqet	8	1,136	1,220
5 Instrumentet financiare derivative		-	-
6 Pasuritë financiare sipas vlerës së drejtë		-	-
7 Pasuritë e klasifikuara si të mbajtura për shitje		-	-
7 Pasuritë e tjera afatshkurtra	9	71,213	54,546
8 Gjithësej pasuritë afatshkurtëra		261,819	269,827
9 Pasuritë afatgjata			
10 Prona,pajisjet dhe implantet	10	11,334,408	11,429,336
11 Investimet e mbajtura deri në maturim		-	-
12 Pasuritë e financiare të mbajtura për shitje		-	-
13 Investimet e trajtuara sipas ekuitetit		-	-
14 Prona investuese		-	-
15 Investimet në vijim		-	-
16 Pasuritë e pa prekshme		-	-
17 pasuritë e shtyra tatimore		-	-
18 Pasuritë e tjera afatgjata		-	-
19 Gjithsej pasuritë e tjera afatgjata		11,334,408	11,429,336
20 Gjithsej pasuritë		11,596,227	11,699,163
<b>II DETYRIMET DHE EKUITETI</b>			
<b>21 DETYRIMET</b>			
22 Detyrimet afatshkurtra			
23 Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	11	48,779	38,490
24 Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër		-	-
25 Tatimet e pagueshme aktuale	12	22,952	28,790
26 Të hyrat e shtyra		-	-
27 Provizionet afatshkurtra		-	-
28 Përfitimet e punonjësve të pagueshme		-	-
29 Detyrimet ndaj lizingut pjesa afatshkurtër		-	-
30 Detyrimet e tjera afatshkurtëra	13	403	2,389
31 Gjithsej detyrimet afatshkurtra		72,134	69,669
32 Detyrimet afatgjata			
33 Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë		-	-
34 Provizionet afatgjata		-	-
35 Detyrimet ndaj lizingut pjesa afatgjatë		-	-
36 Detyrimet e shtyera talmore		-	-
37 Përfitimet e punonjësive të pagueshme		-	-
38 Detyrimet e tjera afatgjata		-	-
39 Gjithësej detyrimet afatgjata		-	-
Gjithësej detyrimet		72,134	69,669
<b>III EKUITETI</b>			
40 Kapitali aksionar		25,000	5,276,141
41 Fitimet e mbajtura	16	(2,699,723)	(2,636,643)
42 Rezervat e tjera	17	14,198,816	8,989,997
43 Gjithsej ekuiteti		11,524,093	11,629,495
44 Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		11,596,227	11,699,163

Drejtori i përgjithshëm/ekzekutiv  
 Luan Hoti

ZKFTH: Arianit Grezda  
 Kontabli i çertifikuar: Emin Sylejmani





NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË  
 QJZ "AUTOBUSKRA STACIONI A.D. PRISHTINA"  
 NPL "BUS STATION" J.S. PRISHTINA

**NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A, prishtinë**

**NRF:600118245**

**NU: 811318741**

**Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019**

	Shenimi	2019 €	2018 €
Të hyrat	14	1,015,465	1,101,309
Kostoja e shitjes	15	(84)	(345)
<b>Fitimi/humbja bruto</b>		<b>1,015,381</b>	<b>1,100,965</b>

Të ardhurat e tjera		-	-
Shpenzimet e shpërndarjes të pagave	15	(829,498)	(893,308)
Shpenzimet administrative	15	(24,336)	(28,879)
Shpenzimet e tjera operative	15	(147,695)	(109,450)
Shpenzimet e zhvlerësimit	15	(78,371)	(245,189)
Fitimet /humbjet tjera - neto		-	-
<b>Fitimi/humbja operativ</b>	<b>16</b>	<b>(64,519)</b>	<b>(175,862)</b>

Shpenzimet financiare		-	-
Të ardhurat financiare		-	-
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>16</b>	<b>(64,519)</b>	<b>(175,862)</b>

Shpenzimet e tatimit në fitim		-	-
<b>Fitimi/humbja i/e vitit</b>	<b>16</b>	<b>(64,519)</b>	<b>(175,862)</b>

<b>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:</b>			
Diferenca këmbi. nga përkthimi i PF-ve të operacio.të huaja neto nga tatimi		-	-
<b>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit</b>		-	-
<b>Gjithësej të ardhurat/humbjet gjithëpërfshirëse të vitit</b>	<b>16</b>	<b>(64,519)</b>	<b>(175,862)</b>

Drejtori i përgjithshëm/ekzekutiv  
 Luan Hoti

ZKFTH: Arianit Grezda

Kontabi.i çertifikuar: Emin Sylejmani

SH. A.  
A. A. D.  
UN. J. S.

SH. A.  
A. A. D.  
UN. J. S.

SH. A.  
A. A. D.  
UN. J. S.



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË  
 KALLI "DREJTICAKUVA" STRADICAT 11 PRISHTINË  
 KRIE "DREJTICAKUVA" 20, PRISHTINË

NPL "Stacioni I Autobusëve" Sh.A, prishtinë

NRF:600118245

NU: 811318741

Pasqyra e rrjedhës së parasë që përfundon më 31.12.2019

	2019	2018
	€	€
<b>I Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>	-	-
Fitimi/humbja i/e vitit	(64,519)	(176,372)
Rregollimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave	-	-
Zhvlerësimi i pronëspaisjeve dhe implanteve	78,371	245,189
Dëmtimi i pronës, paisjeve dhe implanteve	-	-
Amortizimi i pasrive të paprekshme	-	-
Humbja nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme	-	-
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese	-	-
Të ardhurat financiare	-	-
Shpenzimet financiare	-	-
Fitimi/humbja nga shitja e pronës dhe paisjeve	-	-
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
	<u>13,853</u>	<u>68,817</u>
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative		
Rritja / zvoglimi në llogaritë e arketueshme tregtare dhe të tjera	8,352	18,603
Rritja / zvoglimi në stoqe	84	(90)
Rritja / zvoglimi në pasuritë e tjera	(16,666)	-
Rritja / zvoglimi në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	10,281	(23,550)
Rritja / zvoglimi në detyrimet e tjera	(7,817)	-
Rritje/ zvoglim i humbjes nga viti 2017	1,439	-
	<u>(4,327)</u>	<u>(5,038)</u>
Tatimi në fitim i paguar	-	-
Interesi i paguar	-	-
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative</b>	<b>9,526</b>	<b>63,779</b>
<b>II Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>	-	-
Pagesat për blerjen e pronës,paisjeve dhe implanteve	(25,764)	(6,434)
Arketimet për shitjet e pronës,paisjeve dhe implanteve	-	-
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme	-	-
Arketimet për shitjen e pasurive të paprekshme	-	-
Interesi i arketuar	-	-
Dividentat e arketuara	-	-
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese</b>	<b>(25,764)</b>	<b>(6,434)</b>
<b>III Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-
Dividentat e paguara	-	-
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë	-	-
Ripagimi i kredive dhe huave	-	-
Pagesat e lizingut financiar	-	-
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese</b>	-	-
<b>Rritja/zvoglimi neto i parasë dhe i ekuivalentëve të parasë</b>	<b>(16,238)</b>	<b>57,345</b>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	151,818	94,473
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>	<b>135,580</b>	<b>151,818</b>

Drejtori i përgjithshëm/ekzekutiv  
 Luan Hoti

ZKFTH: Arianit Grezda  
 Kontabi i certifikuar: Emin Sylejmani

PRISHTINË

PRISHTINË

PRISHTINË



SH. PËR SHËRBIMIN E QYTYRIT  
 SH. PËR SHËRBIMIN E QYTYRIT  
 SH. PËR SHËRBIMIN E QYTYRIT

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A, prishtinë  
 NRF:600118245  
 NU: 811318741

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet  
 për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat etjera	Gjithsej
	€	€	€	€
Gjendja më 1 janar 2018	25,000	(2,460,781)	5,251,141	2,815,360
Fitimi/humbja i/e vitit		(175,862)		(175,862)
Diferenca nga kembimet valutore				
Dividentat				
Deponimet ekapitalit shtesë				
Ndarja e rezervave			8,989,997	8,989,997
Gjendja më 31 dhjetor 2018	25,000	(2,636,643)	14,241,138	11,629,494
Fitimi/humbja i/e vitit		(63,080)		(63,080)
Diferenca nga kembimet valutore				
Dividentat				
Deponimet e kapitalit shtesë			(25,000)	(25,000)
Ndarja e rezervave			(17,322)	(17,322)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	25,000	(2,699,723)	14,198,816	11,524,093

Drejtori i përgjithshëm/ekzekutiv  
 Luan Hoti

ZKFTH: Arianit Grezda  
 Kontabi i çertifikuar: Emin Sylejmani



NPL "STACIONI I AUTOBUSEVE" SH.A. PRISHTINE  
CIR "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA  
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

**NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A, Prishtinë**

**NRF:600118245**

**NRB:71124851**

**Bill Clinton pn.Prishtinë**



**Politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019**

## **1. Informata të përgjithshme**

Ndërmarrja Shoqërore Stacioni i Autobusëve, është themeluar me vendimi te Kuvendit Komunal te Prishtinës me aktin nr. 110-94/77-01, te datës 15 Nëntor 1977. Ndërsa, kjo ndërmarrje punën e ka filluar ne vitin 1983.

Pas përfundimit te luftës se vitit 1999, kjo ndërmarrje është regjistruar ne baze te rregullores se UNMIK-ut 2000/6 mbi Shoqëritë Tregtare me numër te biznesit 80060165 datë. 14.06.2000 dhe është administruar nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) dhe më pastaj i transformuar Agjencioni Kosovari i Privatizimit (AKP).

Në bazë të nenit 23 të Ligjit nr. 04/L – 111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087, për ndërmarrjet publike, Stacioni i autobusëve SH.A. në Prishtinë është paraparë në Listën 2, ku janë caktuar Ndërmarrjet publike lokale në nivel të Kosovës. Mbi bazën e këtyre ligjeve, Kuvendi Komunal i Prishtinës është pronar i vetëm dhe i ligjshëm i te gjitha aksioneve te ndërmarrjes.

Duke u bazuar në paragrafin 1 të këtij neni, Stacioni i autobusëve, veprimtarinë e tij do ta ushtronte me emërtimin: Ndërmarrja publike lokale "Stacioni i autobusëve", SH.A, Prishtinë i regjistruar me numër te ri te biznesit (NRB) 71224851 me datë 21.01.2015 dhe me numër fiskal pranë ATK-se 600118245. Emërtimin i shkurtër i ndërmarrjes së cekur në paragrafin 2 të këtij neni është: NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A., Prishtinë.

Kuvendi Komunal i Prishtinës ne emër te pronarit te vetëm te aksioneve e ushtron kompetencën dhe përgjegjësinë në bazë te Ligjit, Statutit dhe akteve tjera nënligjore.

Ndërmarrja është e licencuar nga Ministria e transportit dhe Postë Telekomunikacionit për ushtrimin e veprimtarisë së sajë me Licencë me nr.002/18 të datës 02.05.2018. Licenca lëshohet për 5 (pesë) vite e cila ka karakterin e plasimit në kategorizimin e stacioneve e cila sipas licencës në fjale i ka plotësuar kushtet për kategorinë "A" nga katër kategoritë e parapara me Udhëzimin Administrativ (kat. "A","B","C" dhe "D" nga ma kualitative në atë më të dobët).Ndërmarrja posedon sipërfaqe e objekte të mjaftueshme për kryerjen e veprimtarisë si vijon :


- Sipërfaqe 7 ha e 62 ari e 29m<sup>2</sup>, (Fleta Poseduese ZK Prishtinë nr. 8296 me numërprotokolli 2262/02 dt. 10.07.2002.
- Ndërtesa e drejtorisë afërsisht 5228 m<sup>2</sup>,
- Servisi i larjes së autobusëve me dy kanale afër 568 m<sup>2</sup> katrore (e dhënë me qira),
- Perona 21 me nr.rendor prej 1 deri 21 me mbishkrim të linjës. Ndërmarrja posedon edhe objekte përcjellëse si që janë: informata, dispiqeringu, biletarinë, shenjat e komunikacionit vertikal dhe horizontal, stazat dhe parkingu.

Aktivitet e ndërmarrjes janë:

- a) Pranimi dhe përcjellja e autobusëve,
- b) Pranimi dhe përcjellja e udhëtarëve,



Page





- c) Shitja dhe rezervimi i biletave të autobusëve për kompanit e transportit të udhtarëve, kryesisht të sektorit privat, për linjat urbane, urbane periferike, ndërurbane dhe ndërkombëtare,
- d) Informimi i udhëtarëve,
- e) Dhënia e shërbimeve turistike,
- f) Pranimi dhe ruajtja e bagazhit,
- g) Kontrolli i respektimit të rendit të udhëtimit,
- h) Shërbimet tjera që kanë të bëjnë me transportin e udhëtarëve dhe operatorët transportues,
- i) Shfrytëzimi i hapësirave të Stacionit (qiradhënie),
- j) Ndërmarrja mund të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar, i cili lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të paraparë nga legjislacioni në fuqi.

Ndërmarrja ka llogarinë e vet bankare ne NLB Prishtina, në BKT(banka Kombtare Tregtare, një llogari ne ProCredit Bankë por, transaksionet e firmës kryhen përmes llogarisë bankare ne NLB Prishtina ndërsa llogaria në BPB në 2019 është mbyllur.

Ndërmarrja sipas Ligjit dhe Statutit ka Bordin drejtuese të zgjedhur nga komuna e Prishtinës, (aksionari), Kryeshefin Ekzekutiv dhe punëtorët që janë të dizajnuar në shemën organizative dhe me datë 31.12.2019 ka pasë te punësuar gjithsej 97 punëtorë, duke përfshirë ne listën e pagave edhe katër anëtar te bordit te drejtoveve.

## **2. Bazat e përgatitjes dhe Politikat e kontabilitetit**

### **2.1 Përputhshmëria dhe baza e përgatitjes**

Këto pasqyra financiare janë të përgatitura në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Interpretimet (ndryshe IFRS) të botuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) siç janë adaptuar nga Unioni Evropian ("IFRS të adaptuara"), UDHËZIM ADMINISTRATIV MF-NR. 07/2019 PËR STRUKTURËN, PËRMBAJTJEN DHE DORËZIMIN E RAPORTIMEVE FINANCIARE VJETORE Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat matëse te specifikuara ne procedura për çdo lloj të aseteve, të detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë plotësisht të përshkruara në politikat e kontabilitetit më poshtë

### **2.2 Parimi i vazhdueshmërisë**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke u bazuar në parimin e vazhdueshmërisë.

## **2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdimi)**

### **2.3 Standardet, interpretimet dhe amendamentet e reja që hyn në fuqi nga 01 Janar 2015. (VAZHDIMI)**

- SNRF 11 (amendament) – Kontabiliteti i Blerjes së interesave në Operacionet e përbashkëta (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose nga 1 Janari 2016).
- SNRF 10 dhe SNA 28 (amendament) –Shtija apo kontributi i Pasurisë në mes një Investitori dhe Asociacionit të tij ose Ndërmarrjes së përbashkët (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose nga 1 Janari 2016).
- SNA 27 (amendament) – Metodat e ekuitetit në pasqyrat e ndara financiare (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose nga 1 Janari 2016).
- SNA 16 dhe SNA 41 (amendament) – Impiantet bartëse (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose nga 1 Janari 2016).

• Përmirësimet vjetore të SNRF të ciklit 2012–2014. Përmirësimet përfshijnë një përzierje të ndryshimeve thelbësore dhe sqarime, dhe janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2016.

Kompania ka filluar t'i zbatojë këto standarde pas miratimit të tyre.

## 2.4 Valuta e prezantimit

Valuta prezantuese dhe raportuese e Kompanisë është Euro (EUR), ku në përputhje me rregulloret e Bashkimit Monetar Evropian dhe udhëzimeve të lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, Euro ishte adoptuar si valuta e vetme legale në territorin e Kosovës prej datës 1 Janar 2002.

Në vijim janë politikat themelore të kontabilitetit të adaptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra janë përgatitur në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Raportimit Financiar (SNFR). Pasqyrat financiare janë përgatitur nën marrëveshjen e kostos historike, ndërsa e modifikuar për paraqitjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve në shumat e rivlerësuara sikurse janë të përshkruara tutje në këto shënime.

Përgatitja e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF kërkon përdorimin e parashikimeve të shpeshta kritike të kontabilitetit. Gjithashtu kërkojnë nga menaxhmenti të ushtrojnë gjykimin e tyre në proceset e aplikimit të politikave të kontabilitetit. Megjithatë këto parashikime janë bazuar në njohurit dhe ngjarjet e tanishme dhe veprimet më të mira të menaxhmentit, rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të parashikuara.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur për vitin deri me 31 dhjetor 2019. Të gjitha të dhënat janë të shprehura në vlera Euro.

## 2.5 Adoptimi i Standardeve të reja dhe të reviduara

Në vitin e tanishëm, Kompania ka adoptuar të gjitha Standardet e reja dhe të rishikuara dhe interpretimet e lëshuara nga Bordi i Standardeve Nderkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe të Komitetit Interpretues Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (KINRF) të (BSNK) të cilat janë relevante në aktivitetet e saj dhe efektive për periudhat raportuese vjetore. Adoptimi i Standardeve të reja dhe të reviduara dhe Interpretimet nuk kanë rezultuar në ndryshimet e politikave të kontabilitetit të Ndërmarrjes.

## 3. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit

### 3.1 Prona, impiantet dhe pajisjet

Zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve që ekzistojnë me 1 janar 2019 janë bartur sipas kostos së tyre historike, minus zhvlerësimi i akumuluar pasues Kosto paraqet shpenzimin që i atribuohet drejtpërdrejtë përvetësimit (blerjes) të zërave. Kostot pasuese janë përfshirë në vlerë bartëse të mjeteve apo është njohur si mjet i veçantë, në mënyrë të duhur, vetëm atëherë kur përfitimet ekonomike të mundshme lidhur me këtë mund të rrjedhin në Kompani dhe kostoja e mjetit mund të matet besueshëm. Të gjitha riparimet tjera dhe mirëmbajtja ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur. Gjatë vitit 2018 është bërë edhe Vlerësimi i pronës ku zhvlerësimi i objekteve përfshinë vlerën e cila buron nga vlera më e ulët se vlera kontabël.

Zhvlerësimi i pasurive është bërë me metodën drejtvizore për të alokuar kostot e tyre ose shumat e rivlerësuara të vlerave të mbetura mbi jetën e përdorimit të parashikuar, siç vijon:

Ndërtesat	5%
Pajisjet prodhuese dhe makineria,	10%
Kompjuterët, Pajisjet e zyrës, veturat	20%

Vlerat e mbetura te pasurive dhe jeta e përdorimit janë rishikuar, dhe rregulluar nëse është e nevojshme, në secilën datë të bilancit të gjendjes. Vlera bartëse e një pasurie është e shënuar menjëherë në vlerën e saj të rikuperueshme nëse vlera bartëse e pasurisë është më e madhe se sa është parashikuar vlera e rikuperueshme.

Humbjet ose fitimi janë përcaktuar nga rrjedha e krahasimit me vlerën bartëse. Këto janë të përfshira në pasqyrën e të ardhurave.

### 3.2 Dëmtimet e asetëve jo-financiare

Pasuritë të cilat kanë jetë përdorimi të padefinuar nuk i janë nënshtruar zhvlerësimit dhe testohen çdo vit përdëmtimin në vlerë. Pasuritë të cilat i nënshtrohen zhvlerësimit janë rishikuar për dëmet kurdo që ndodhin ose në rrethanat të cilat e shtyjnë që vlera bartëse nuk mund të rikuperohet.

Humbjet nga dëmet janë njohur për vlerën të cilën e kalon vlerën e rikuperueshme të vlerës bartëse të pasurisë. Vlera e rikuperimit është vlera më e madhe në mes të vlerës së një pasurie në përdorim dhe vlerës fer të saj minus kosto e shitjes. Për qëllime të vlerësimit të dëmeve, pasuritë që nuk mund të testohen në mënyrë individuale janë të grupuara në nivelin më të ultë të pasurive që gjenerojnë para nga përdorimi i vazhdueshëm i tyre e qëj anë të pavarura nga pasuritë tjera ose grupe të pasurive. Pasuritë jo-financiare të cilat janë dëmtuar janë rishikuar në rëndësi pezullimi të dëmeve në secilën datë raportimi.

### 3.3 Asetet Financiare

Asetet Financiare klasifikohen në kategoritë e specifikuar vijuese: mjetet financiare në vlerën reale përmes fitimit apo humbjes, kreditë dhe të arkëtueshmet, mallrat e gatshmet për shitje. Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i mjeteve financiare që janë përvetësuar. Menaxhmenti e përcakton klasifikimin e mjeteve financiare në njohjen fillestare. Deri në datën e bilancit të gjendjes Kompania nuk ka asetë të klasifikuar në kategoritë e vlerës fer përmes Fitimit apo Humbjes asetëve të gatshme për shitje. Blerjet dhe shitjet e asetëve financiare njihen në datën e tregtimit-data kur Kompania zoton blerjen apo shitjen.

Kreditë dhe të arkëtueshmet janë asetet financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktuara që nuk janë kuotuar në treg aktiv. Janë të përfshira në asetet qarkulluese, përveç atyre që maturohen pas 12 muaj pas datës së bilancit të gjendjes. Këto janë klasifikuar si pasuri jo-qarkullues. Kreditë dhe të arkëtueshmet e Kompanisë përbëhen prej „të arkëtueshmeve tregtare tjera, parasë dhe ekuivalenteve të parasë në bilancin e gjendjes.

### 3.4 Të arkëtueshmet tregtare dhe tjera

Të arkëtueshmet tregtare njihen në fillim në vlerën e tyre reale dhe më pas të matura më koston e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit, minus provizionin për dëme. Provizionin për dëmet e të arkëtueshmeve tregtare është vendosur aty ku ka dëshmi të mjaftueshme që Kompania nuk do të jetë në gjendje t'i mbledh të gjitha shumat sipas kushteve origjinale. Vështirësitë e mëdha të debitorit, me gjasë që debitori do të bankrotoj apo do të riorganizohet financiarisht, mos pagesa apo gabimi në pagesa (që vonohen më shumë se 30 ditë) konsiderohen si indikator që të arkëtueshmet tregtare janë dëmtuar. Shuma e provizionit është diferenca në mes vlerës bartëse të asetëve dhe vlera prezentë e vlerësuar e rrjedhjes së parasë në të

ardhmen, e zbritur në normën origjinale efektive të interesit. Asetet me maturi afatshkurta nuk janë zbritur.

Vlera bartëse e mjeteve zvogëlohet për mes përdorimit të një kontoje për lejime, dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave në „koston e shitjeve dhe të marketingut“. Kur një e arkëtueshme tregtare është e pambledhshme, shlyhet kundër kontos për lejimet e të arkëtueshmeve tregtare. Paraprakisht kthimi i shumave, të shlyera më parë kreditohen kundër „koston e shitjeve dhe të marketingut në pasqyrën e të ardhurave.

### 3.5 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë mbahen në bilancin e gjendjes sipas koston. Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paranë në dorë dhe depozitat e mbajtura në bankë të pa afatizuara.

### 3.6 Kapitali aksionar

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej
	€	€	€	€
Gjendja më 31 dhjetor 2018	25,000	(2,636,643)	14,241,138	11,629,494
Gjendja më 31 dhjetor 2019	25,000	(2,699,723)	14,198,816	11,524,093

Kapitali aksionar përbehet nga vlera reale e monetare e evidentuar dhe kontribuar nga aksionaret e Kompanisë. Vlenë të theksohet se në bazë të statutit të ndërmarrjes me rastin e themelimit të NPL “Stacioni i autobusëve” Sh.A, Prishtinë ka të paraqitura aksione në vlerë prej 25,000.00€.

Në PVF të vitit 2019 kemi Kapital Aksionar me vlerë prej 25,000.00 ndersa pjesa tjetër e kapitalit mbetet si Rezerve teknike 14,198,816.27 € , si dhe Fitimet e mbajtura e zvoglojnë vlerën prej (2,699,723€) dhe totali i pergjithshem i Ekuitetit (Kapitalit të Pronarit) është 11,524,093€.

### 3.7 Beneficionet e të punësuarve

Kompania kontribuon për punëtorët e saj në planet pas pensionimit si janë të përshkruara nga legjislacioni për kontributet pensionale. Kontributet, bazuar në paga, bëhen në organizatën kombëtare përgjegjëse për pagesat e pensioneve. Nuk ka ndonjë detyrim shtesë lidhur me këto plane dhe këto skema konsiderohen si plan i caktuar i kontributeve.

Kompania nuk ka beneficione pas pensionimi për punëtorët e tyre.

### 3.8 Të pagueshmet tjera dhe tregtare

Të pagueshmet tjera dhe tregtare njihen në vlerën reale dhe më pas maten me koston e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit.

### 3.9 Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të hyrat njihen atëherë kur ekziston dëshmia bindëse, që zakonisht është në formë të marrëveshjeve për shitje, pasi që reziqet dhe përfitimet domethënëse të pronësisë janë transferuar tek blerësi dhe kthimi i mundshëm i mallrave mund të vlerësohet në mënyrë të arsyeshme. Të hyrat nga shërbimet njihen në pasqyrën e të ardhurave në proporcion me fazën e përfundimit (kompletimit) të transaksionit në datën e raportimit. Faza e kompletimit vlerësohet

duke iu referuar ekzaminimit të punës së kryer. Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në kohën e pranimit të shërbimit ose në datën e origjinës.

### **3.10 Provizionet**

Provizioni njihet kur Kompania ka një obligim të tanishëm si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe kompania ka një obligim aktual ose të parashikuar që mund të vlerësohet në mënyrë të arsyeshme dhe është e mundshme të kërkohej rrjedhë dalëse e përfitimeve ekonomike për të paguar obligimin. Provizionet janë rishikuar në çdo datë të bilancit të gjendjes dhe rregulluar të reflektuar parashikimet me të mira të tanishme. Kur ndikimi i vlerës në kohë të parasë është material, shuma e provizionit është vlera e tanishme e shpenzimeve të pritura që do kërkohej të vendoset obligimi.

### **3.11 Zotimet dhe kontingjencat**

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato shpalosen vetëm nëse mundësia e rrjedhës së burimeve është e largët. Pasuria kontingjente nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset kur ardhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme. Shuma e humbjeve kontingjente njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme do ta konfirmojnë at detyrim të shfaqur në datën e bilancit të gjendjes dhe parashikimi i arsyeshëm i shumës së rezultuar të humbjes që mund të bëhet.

## **4. Gjykimet kritike në aplikimin e politikave të kontabilitetit të Kompanisë**

Në aplikimin e politikave të kontabilitetit, të cilat janë të përshkruara në Shënimin 3, nga menaxhmenti kërkohej që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime në lidhje me shumën e bartura të aseteve dhe detyrimeve të cilat nuk janë lehtësisht të qarta nga burimet tjera. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura janë të bazuara në përvojën historike dhe faktorët tjerë të cilët konsiderohen të jenë relevantë.

## **5. Burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim**

Supozimet kryesore në lidhje me të ardhmen, dhe burimet tjera kryesore të pasigurisë në vlerësim në datën e bilancit të gjendjes, të cilat paraqesin një rrezik domethënës për të shkaktuar korrigjime materiale në vlerën e bartur të aseteve dhe detyrimeve brenda vitit financiar vijues, janë diskutuar më poshtë:

**Provizioni për llogaritë e arkëtueshme tregtare:**

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën vlerësime për kthimin dhe realizimin e llogarive të arkëtueshme. Duke u bazuar në këtë, menaxhmenti regjistron një provizion përkatës për dëmtimin e kërkesave. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara.

**Vlerësimi i rasteve ligjore:**

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën një vlerësim për shumën që nevojiten për shlyerjen e rasteve ligjore sipas udhëzimit të këshilltarit ligjor të Kompanisë. Në bazë të këtij vlerësimi, Kompania në përputhje me këtë regjistron provizionin, nëse ka, apo shpalos detyrimin kontingjent. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara.

Vlerësimi për çështjet ambientale, çaktivizimin dhe çështjet tjera të ndërlidhura, aktualisht nuk ka asnjë kërkesë detyruese ligjore për mjedisin, çaktivizimin dhe dispozitat tjera të lidhura në Kosovë

## 6. PARAJA E GATSHME

Paraja e gatshme në fund të periudhës përbëhet nga pjesa e mbetur e parave që zotëron subjekti më 31.12.2019 në llogaritë bankare me të cilat bashkëpunon, në ProCredit Bankë, në BKT , NLB Bankë Prishtina . Subjekti aplikon sistemin e hyrjeve të dyfishta në lidhje me të gjitha transaksionet ekonomike që ndodhin në periudhë. Subjekti bënë regjistrimin e transaksioneve bankare dhe bënë konsolidimet bankare me parane e gatshme në fund të vitit. Paraja ne banke dhe arke me date 31.12.2019 është 135,179 €

## 7. LLOGARIA E ARKËTUESHME

NR	Llogaritë e arkëtueshme më 31.12.2019	31.12.2019	31.12.2018
1	Arbeni Tours	0.00	200.9
2	Adio tours	100.00	0
3	Dardani	536.80	1020
4	Niku tours	648.80	648
5	Shari NPQ	322.40	744
6	Auto one shpk	-	27
7	Taxi-Grupi i Taxive	(0.20)	0
8	Buçaj	16.00	16
9	Instruktori-Auto shkolla	22.61	22.61
10	Anita - Autoshkolla	52.16	52.16
11	Atlandida - Autoshkolla	0.26	0.26
12	Verona - autoshkolla	-	39
13	Vllzerit Kamberi-autoshkol	12.00	27
14	Hilli autoshkolla	13.51	13.51
15	Universal Impex		36
16	ABC autoshkolla	(10.00)	0
17	Abis autoshkolla	40.51	40.51
18	Patenta autoshkolla	13.50	13.5
19	Ari autoshkolla	13.50	13.5
20	EGRO-C autoshkolla	25.50	25.5
21	Stop autoshkolla	27.00	27
22	Daxa autoshkolla	13.50	13.5
23	Floriani Istog	322.40	342
24	Urban Autoshkolla	40.50	40.5
25	Lumi ashk	-	8.5
26	Albioni ashk	-	18
27	Vlora ashk	27.00	27
28	Bio Lab	16.00	16
29	MENDI	39.00	39
30	EDI tours	42.70	42.7
31	Pagesa per humbje kartelave	(4.24)	-5
32	VICTORIA TOURS	113.94	0
33	UNIONI NPT	57.20	0
34	KUNEVIKET	3,695.83	4326.18
35	MAKI	1,409.23	2904.36
36	UNIVERZAL IMPEX	66.27	37.66
37	ILIRI-Euroh.QENDRESA-1	1,313.69	1313.69
38	"TURIST KOSOVA"	-	230.88
39	DUSHI	625.24	2369.26

40	QAMIL GASHI Liria	8,348.12	8348.12
41	DONI N.SH	1,559.89	5423.34
42	Komp.e sigur."KOSOVA"	0.28	0.28
43	Qendresa-Restorani-SHPK	1,197.30	0
44	VICTORY TAXI	2,403.33	0
45	Minis.Trans.Telekomun.	7,106.97	15416.57
46	Qendresa-Banaku	6,962.12	3348.25
47	Adem Zeka DPT	3,070.88	3070.88
48	Bici com	3,966.71	5111.08
49	Niku tours	130.77	130.77
50	Qendresa-Parking i autobu.	750.00	750
51	Zhuja	2,054.06	4595.28
52	PK-Posta e Kosovës	2,807.90	2807.82
53	N.T.Sh.VLLESA	67.90	67.9
54	DTP Rilindja Muhamet Veliu	86.81	1837.7
55	Atmaxha	817.50	0
56	Fadili tours	218.00	0
57	Qendresa-Zyre	314.97	161.6
58	N.T.P. G.T.T.Service	45.94	43.27
59	Rehatija DPH	3,918.93	3918.93
60	Shpk Euroloto HD-Caffe	611.12	1989.22
61	NPTSH Skenderaj Commerc	1,104.09	1104.09
62	N.Sh.Albi & Andi	-	-352.98
63	N.SH."Albi & Andi"-1	2,006.91	1710.54
64	Ganimete Pacolli B.I	830.58	1317.33
65	Bekim Kosova'B.I	277.20	273.39
66	Shaban Rafuna	131.51	216.23
67	Qendresa Pirgu	3,188.55	1578.98
68	Qendresa 1 m-sportelave	2,099.18	490.8
69	Ennui shpk	159.27	167.94
70	American Sport Bar	-	109
71	Bici com -sportel	218.00	0
72	Qazim k.Berisha B.I-Sportel	1,090.00	0
73	Zhitia Turist-sh.p.k-sporte	654.00	0
74	Shpejtimi sh.p.k-sportel	654.00	0
75	Deva tours n.sh.t-tours	1,362.50	0
76	Albin Zeneli B.I (BINO J)	451.66	0
77	Ganimete Pacolli 6	53.58	0
78	Prov.borxh.të kqja TRIUMFI	453.57	453.57
79	Prov.borxh.të kqja KRENARIA	8,220.46	8220.46
80	Prov.borxh.të kqja DARDANIA	26,496.66	26496.66
81	Prov.borxh.të kqja BUREKTOR	2,965.06	2965.06
82	Turist Kosova -Borxh i keq	34,530.43	34530.43
83	Kompani.e sigu.Kos.e Re.B.K	549.12	549.12
	BLERSIT NE VEND	143,548.40	151542.31
84	Provizioni i borxh,kqja Qamil Gas	(8,348.12)	(8348.12)
85	Provizioni i borxh.kqja Adem zeka	(3,070.88)	(3070.88)
86	Provizioni i borxh.kqja Rehatia DP	(3,918.93)	(3918.93)
87	Provizioni i borxh.kqja NPTSH Sken	(1,104.09)	(1104.09)
88	Provizioni i borxh.kqja Triumfi	(453.57)	(453.57)
89	Provizioni i borxh.kqja Krenaria	(8,220.46)	(8220.46)

90	Shly.borxh.kqia.Dardania	(26,496.66)	(26496.66)
91	Provizioni iborxh.kqia Burektorja	(2,965.06)	(2965.06)
92	Provizioni iborxh.kqia Tursit Kos	(34,530.43)	(34530.43)
93	Provizioni iborxh.kqia Kosova e R	(549.12)	(549.12)
	Vlera e korigjuar	(89,657.32)	(89657.32)
	Shuma e te gjithë blerësve	53,891.12	61884.99

Tabela më lartë paraqet kërkesën ndaj një klienti për pagesë më 31.12.2019.si dhe pjesën e provizionuar e cila është bartë nga vitet e më parshme por që borxhi ende nuk është shlyer në tërësi . Në vitin 2019 nuk është bërë ndonjë shlyerje e borxheve të këqia pasi se do të bëhet përpjekje për inkasimin e tyre nëpër mes të përmbaruesit privat. Ndërsa në pasqyrën e gjendjes së pozitës financiare është paraqitur vlera neto e saldosh të Llogarive të arketueshme në shumën prej 53,891€.

## 8.STOQET

Stoqet ne pasqyrat fiananciare kompania i ka paraqit në vlerë prej 1,136 euro, ( në vitin 2018 kane gene ne vlere prej 1,220 euro). Këto vlera nuk kan të bëjnë me material i cili është blerë për rishitje, por është material harxhues si bileta për peronizim dhe ndonji material tjetër zyrtar i cili gjindet në depo.

	2019	2018
Lënda e parë dhe materiali	<u>1,136</u>	<u>1,220</u>
	1,136	1,220

## 9.Pasuritë afatshkurtëra

LL/A nga klientët e kaluar -Huadhënia për Sh.A."Plastika" Prishtinë	7,669 €
LL/A nga klientët e vjetër - Huaja e dhënë Kosovatrans – Lipjan	767 €
Kërkesat nga punëtorët	285 €
Paradh.e tatimit në fitim	1,882 €
Paradh.e tatimit në Qira dhe tatimit në fitim	60,260 €
Paradhanje	349 €
<b>Total</b>	<b>71,213 €</b>

Në vitin 2019 nuk është bërë inkasimi i huasë nga klienti Sh.A Plastika dhe Kosovatrans – Lipjan. Kërkesa ndaj këtyre klientëve janë që nga viti 2002,lënda ndaj tyre është në procedur gjyqësore. Paradhënjet e tatimit në fitim dhe tatimi i mbajtur në burim nga qiraxhinjët nuk janë kthyer nga ATK. Paradhënja ndaj KUJR Prishtina në një faturë është paguar sipas borxhit total edhe pse fatura paraprake ishte e paguar me kohë,prandaj vlera prej 349€ do të rregullohet në vitin 2020. Vlera e këtyre kërkesave është një saldo përfundimtare e paraqitur në pasqyrën e gjendjes së pozitës financiare në shumë prej 71,213€.



## 10. PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

	Toka	Ndërtesat	Pajis, inven, kompju.	Puna në proces	Gjithsej
	€	€	€	€	€
<b>Kostoja</b>					
Më 1 janar 2018	1,158,869	1,390,452	103,084	-	2,652,405
Shtesat gjatë vitit	8,931,131		53,306	-	8,984,437
Transferet	-	-	-	-	-
Riklasifikimet	-	-	-	-	-
Shlyerjet	-	212,564	19,942	-	232,506
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>10,090,000.00</b>	<b>1,177,888</b>	<b>136,448</b>		<b>11,404,336</b>
Shtesat gjatë vitit 2019		3,848	21,917	-	25,765
Transferet	-	-	-	-	-
Riklasifikimet	-	-	-	-	-
Shlyerjet	-	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>10,090,000.00</b>	<b>1,181,736</b>	<b>158,365</b>		<b>11,430,101</b>
Zhvlersimi i aseteve për 2019		59,009	36,942		95,693
<b>Gjendja e aseteve më 31.12.2019</b>	<b>10,090,000.00</b>	<b>1,122,727</b>	<b>121,423</b>		<b>11,334,408</b>

Subjekti posedon parcelën prej 7 ha e 62 ari e 29 m<sup>2</sup>, dhe objektin ku zhvillon aktivitetet. Ndërmarrja NPL Stacioni i Autobusëve ka bërë vlësimin e pronës në dhjetor të vitit 2018, ku si rrjedhojë rezultojnë me një ngritje të vlerës së Tokës për 8,931,131.40€ nga vlera kontabël, kurse tek Objektet ndërtimore vlera e tyre sipas raportit vlersues paraqitet më e vogël se sa vlera kontabël në vlerë prej 212,564.00€ e cila është paraqitë si shlyrje e objekteve ndërtimore. Vlerat e aseteve më 31.12.2018 janë bartë në vitin 2019. Gjatë vitit 2019 ndërmarrja ka pasë një rritje të aseteve ndërtimore në hapjen e një pusi në vlerë prej 737.24€ dhe ndërtimin e shtëpizave për shitje të biletave në vlerë prej 3,110.59€. Po ashtu gjatë vitit 2019 janë blerë paisje dhe inventar në vlerë prej 21,917.00€.

Gjatë punimit të PFV-e vlefshmëria e aseteve është konstatuar duke u bazuar në mbështetje të qëndrueshme të dokumentacionit që argumenton pohimet e paraqitura në pasqyra financiare për asetet në tërsi. Duke u bazuar në dokumentacionin e regjistrimit vjetor të aseteve dhe ekzistencës së pajisjeve mund të konkludojmë se pajisjet ekzistojnë.

## 11. LLOGARITË E PAGUESHME dhe DETYRIMET TJERA

nr	Llogarite e pagueshme	2019	2019
1	BELI	330.42	330.42
2	BARILEVA	2,923.90	3,674.50
3	ALBUS	1,007.10	1,149.00
4	HANI KOM	142.20	306.90
5	DURMO TOURS	198.90	137.10
6	ATMAXHA-Prizren	680.10	1,004.10
7	ERHAN-TRANS-Prizren	1,493.80	1,484.80
8	V%LLEZRIT THA#I-Drenas	1,147.50	1,206.00
9	ARBENI-	1,291.50	1,656.00
10	EURO-LINE Strug%	1,336.50	565.20
11	BENKO	209.00	139.70
12	BEKO-Shkup	1.20	1.20
13	AMALFI	1,521.90	1,665.40
14	Robi	-	(2.00)
15	Arditi	3,978.00	3,037.50
16	FJOLLA IMPEX	238.50	288.00
17	Memi-Lipjan	87.69	186.69
18	Metropol-Tirana	1,222.50	1,245.00
19	Albatros-Podujev%	206.98	206.98
20	Motoja	328.30	-
21	Aurora	444.25	633.25
22	Kabashi	981.00	450.00
23	Kei-reisen	387.50	927.50
24	Shpresa AL	544.00	337.00
25	Hisari	3,219.08	1,773.00
26	Era Tours	192.79	274.69
27	Shar travel-Sh	4,452.60	3,773.60
28	NTSH Vector	135.00	117.00
29	Motoja - Si	207.00	477.24
30	ADIO-SHPK	333.08	1,116.38
31	Kujtimi Previzaj	-	45.00
		29,242.29	28,207.15
32	NKP "HIGJIE-TEKNIK"Pastrimi	952.26	1,340.00
33	PTK	307.24	(28.04)
34	Furn.e rrym%os "ELEKTR.KOSOV	6,324.70	6,130.13
35	BATLLAVA-KUJR Prishtina	-	665.84
36	KDA-Kosova.Divl.agensi/pl.b	(0.80)	(0.80)
37	Informatika computers	-	177.00
38	N.T.SH.Enternet	-	171.54
39	Zyra per gazet zyrtare	104.00	48.00
40	Europrinty	134.99	-
41	Koha ditore	554.00	554.00
42	Bota sot	80.99	80.99
43	D.P.T "Adi"	58.20	661.34
44	Petrol Company SH.P.K	311.04	-
45	Al Petrol Shpk	-	2.78
46	ELTRISI ShPK	81.98	-
47	NTP Igmaz	16.50	-

48	HD cafe	109.30	-
49	IPKO	259.14	-
50	Al Petrol Shpk	2.78	-
51	Viva fresh stor	(0.80)	-
52	Dri-Den ntp	56.34	-
53	Bau Market	147.92	-
54	Epoka e re	99.00	99.00
55	PRUDENCIA STUDIO LIGJORE	80.00	80.00
56	Universi	24.00	-
57	TELKOS	0.08	0.08
58	Dugagjin Rudi B.I	(0.01)	20.00
59	rikon	(0.01)	151.26
60	Asdren Bytyqi avokat	99.00	99.00
61	D.P.Z SIEMENS	90.00	-
62	Portal Pune SHPK	30.00	-
63	N.T.P LAS PALLMAS	83.50	-
64	TAV.DARDHA SH.P.K	1,206.00	-
65	INFOTECH	25.00	-
66	NTP ARI HOGOSHT	63.00	-
67	PANTHER SHPK	70.42	-
68	KONAKU	4,358.08	-
69	Kafe vending ILLY shpk	(0.09)	-
70	BESA SECURITY	508.38	-
71	Obligimet per qytetar	50.00	-
72	Envioni	745.76	-
73	Ganimete Pacolli BI	425.94	-
74	foto Nesha	144.00	-
75	Sallhu-Keys	268.00	-
76	ACA-Audit Consulting Asspci	354.00	-
77	N.SH."ALBI & ANDI"	798.60	-
		<b>19,022.43</b>	<b>10,252.12</b>
	<b>FURNITORET NE VEND</b>	<b>48,264.72</b>	<b>38,459.27</b>

Llogaritë e pagueshme në fund të periudhës 31.12.2019, janë paraqitur në Bilancin e gjendjes në vlerë prej 48,779 të cilat përfshijnë obligimet për llogaritë e rregullta tregtare në shumë prej 48,264.72€ dhe obligimet për sindikatën e puntorëve prej 514.16€.

## 12. TATIMET E PAGUESHME

Detyrimete epagueshme tatimore	më	31.12.2019
LI/P për tatimet, TVSH (DHJETOR 2019)		11,742.25€
Tatimi në të ardhura i pagueshëm		4,386.94€
Kontributi pensional nga punëtori i pagueshëm		3,411.50€
Kontributi pensional nga punëdhënësi i pagueshëm		3,411.46€
<b>Totali i detyrimeve tatimore</b>		<b>22,952.11€</b>

## 13. DETYRIMET E TJERA

Detyrimet e tjera paraqesin avanset e marura nga klientet dhe në bilancin e gjendjes më 31.12.2019 në pasivë në shenimin 11 janë paraqitur në vlerë prej 403.04€

#### 14. TË HYRAT

Kompania realizon të hyrat nga këto aktivitete si më poshtë:

Pershkrimi	viti 2019	viti 2018
Të hyrat nga shërbimi i Sta	47630.19	24597.2
Të hyrat nga parkingu	120551.5	115493.45
Të hyr. nga provizioni	30096.46	35040.54
Të hyrat nga peronizimi	527624.95	557203.96
Të hyrat nga sher.në portë	52590.74	15332.25
Te hyrat nga garderoba	136.43	0.84
Të hyrat,nga kartel,hyrje,d	80.51	159.41
Të hyrat nga FLEXUS-reklama	380	114.41
Të hyrat,plat.0.10		60860.49
Të hyrat,plat.0.50		15380.93
Të hyrat plat 1.00	514.4	23944.03
Të hyrat plat 5.00		228.8
Të hyrat plat 16		907.85
Të hyrat plat 18		259.31
Të hyr.mujo.20 dhe 25 Furni	1260.63	3610.87
Të hyr.A.SH.muj.13.50 dhe 2	6236.46	19163.1
te hyrat nga 3.00	767.79	3806.39
Te hyrat nga mbyllja e avansit		11408.68
TE HYRAT NGA SHITJA E ShËRBIMEVE	787870.06	887512.51
Të hyrat nga qirat	181756.29	166671.81
Tëhyrat nga qiraxh.-rryma	38462.17	38410.55
Të hyrat nga qiraxh.-uji	5435	5111.37
Të hyrat nga qiraxh.-mbetur	576	3602.9
Të hyrat nga sherb.me uj	525.42	
TE HYRAT NGA QIRAGJINJËT	226754.88	213796.63
Të hyra.nga shitja e Mj.The	187.71	
Të hyrat nga shitja e barit	169.49	
Të hyrat nga asgjas.i mjete	389.82	
Të hyrat nga demtimi laures	92.97	
FITIMI NGA SHITJA E MJ.TH.D	839.99	
Gjithsej klasa	1015464.93	1101309.14

Të hyrat nga peronizimet, janë te hyrat kryesore te kompanisë qe përfshijnë 52% te totalit te hyrave dhe njihen nga pagesat e peronit të stacionit të autobusëve konform UA NR. 08/2013. Stacioni ka 170 kompani (138 ndërurban dhe 32 kompani që operojnë jashtë kufijve të Kosovës ndërsa, 42 kompani operojnë ne relacionet urbano-periferike kryesisht ne relacionet e Llapit, Gollakut dhe Vushtrisë me rreth 133 nisje ditore por, nuk hyjnë ne stacionin e autobusëve.

Të hyrat nga qiraja paraqesin qiratë me aktivitetet biznesore që zhvillohen në hapësirën e lokacionit të Stacionit,si dhe të hyrat të cilat iu janë faturuar qiraxhinjëve në emër të participimit në shpenzimet e rrymës ujit dhe mbeturinave.Prej muajit prill 2019 KE ka rregulluar faturimet e

shpenzimeve të mbeturinave ku kompanija e pastrimit i faturon në mënyrë direkte qiraxhinjëve prandaj Stacioni është liruar nga faturimi i mbeturinave për pastrim . Në proces është edhe rregullimi i faturimeve për rrymë dhe ujë dhe për vitin 2020 edhe kjo çështje do të zgjidhet sepse ishte rekomandim nga raporti i auditorit nga viti 2018.

Një pjesë e hapësirës së stacionit shfrytëzohet për parking me pagesë.

## 15. SHPENZIMET OPERATIVE

Shpenzimet e materialit	2019	2018
a) Materiali dhe lënda e parë	-	-
b) Shpenzimet e mallit të shitur	84	345
c) Shpenzimet tjera	-	-
Shpenzimet e materialit (a+b+c)	<u>84</u>	<u>345</u>
<b>Shpenzimet e pagave bruto</b>	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Pagat dhe medijtjet	790,004	850,769
Kontributi për sig.pens/Punëdhënës	39,493	42,538
	<u>829,498</u>	<u>893,308</u>

Kompania në emër të punëtorëve bën llogaritjen e pensioneve dhe tatimeve në pagën bruto të punëtorëve dhe i paguan ato në bazë të ligjeve në fuqi. Këto shpenzime paraqiten në pasqyrën e të ardhurave në periudhën e njëjtë së bashku me shpenzimet e të ardhurave.

Kompania nuk ka ndonjë skemë shtesë pensionale apo të pensionimit të punëtorëve të saj, andaj edhe nuk ka obligime për pensione. Për më tepër, kompania nuk është e obliguar të siguroj benefite shtesë për punëtorët e tanishëm apo të mëparshëm. Kompensimi i punëtorëve bëhet konformë ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve administrative dhe praktikave të mira si kontrata e përgjithshme kolektive dhe anekset e saj etj. Bazuar në këto ligje dhe udhëzime kompania pos pagës bazë u njuh edhe mjetet shtesë për ndërrimin e natës 30%, ditët e festave 50% shujtën e ngrohtë në vlerë prej 3.00€ për një ditë si dhe për punën e kaluar prej 0.5% për çdo vit të përvojës së punës.

Shpenzimet e tjera	2019	2018
Shpenzimet Administrative	15,686.97	18,185.20
Shpenzimet e telefonit	8,649.36	10,694.18
Shpenzimet e rrymës	50,131.67	52,431.48
Shpenzimet e mirëmbajtjes	44,591.96	11,351.82
Provizionimi dhe shlyrja e borxheve		0.00
Shpenzimet e tjera operative	52,971.31	45,667.01
<b>Totali</b>	<u>172,031.27</u>	<u>138,329.69</u>

Në shpenzimet administrative në vlerë prej 15,686.97 përfshihen shpenzimet e reprezentacionit në shumë prej 4,954.94€, në të cilën janë përfshi : dreka për 8 mars në vlerë prej 466.10€, iftari i shtruar për punëtorët në vlerë prej 438.56€, dreka me BD 292.20€, dreka me unionin e Stacioneve të Autobusëve 240.08€, dhe darka e fundvitit me punëtorër 1022.03€, ku shpenzimet për reprezentacion të përfaqësimeve tjera janë 2495.97€. Në këto shpenzime po ashtu janë përfshi shpenzimet ematerialit për zyre 3,200.00€, Shpenzimet derivateve 1,188.36€, Shpenzimet për

tendere 499.50€ shpenzimet për angazhim të avokatit 1,296.00€, shpenzimet për përkthime 200.00€ shpenzimet për derivate KIA 1,129.31 dhe tjera. Gjithashtu në pasqyrën e të ardhurave në këtë pozicion janë përfshi edhe shpenzimet e telefonit në vlerë prej 8,649.36€.

Amortizimi dhe zhvlerësimi	2019	2018
Zhvlerësimi	<u>78,371.41</u>	<u>245,188.78</u>
	78,371.41	245,188.78

Sa i përket amortizimit dhe zhvlerësimit specifikohet që të njëjta janë kalkuluar në bazë të jetës së dobishme të aktiveve dhe shfrytëzimit të tyre në gjatësinë e përdorimit. Më 2018 në pozicionin (zërin) e zhvlerësimit është shtuar edhe pjesa e nënvlerësuar e objekteve ndërtimore e cila sipas librave në kontabilitet ishte më e madhe me rastin e vlerësimit të objekteve ndërtimore dhe të pronës. Ky nënvlerësim është regjistruar në emër të zhvlerësimit të aseteve. Ndërsa zhvlerësimi më 2019 është i paraqitur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në vlerë prej 78,371.41

#### 16. FITIMI (HUMBJA) PARA TATIMIT

	2019	2018
Fitimi (humbja) para tatimit	<u>-64,519.00</u>	<u>-176,372.11</u>
	-64,519.00	-176,372.11

Diferenca në mes të hyrave dhe shpenzimeve paraqet rezultatin e vitit afarist

Viti	2019	2018
Të hyrat	1,015,464.93	1,100,799.08
Shpenzimet	<u>1,079,983.68</u>	<u>1,277,171.19</u>
Humbja e vitit	(64,518.75)	(176,372.11)

Tatimi në atë ardhura paraqet shumën e tatimit e cila është e pagueshme dhe tatimin e përlogaritur. Tatimi i cili llogaritet dhe paguhet në pajtim me Ligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, Ligji Nr.05/L-29. Tarifa për tatimi në fitim të korporatave është 10%, duke u bazuar në fitimin vjetor të rregulluar për njësitë, të cilat janë të matshme. Firma ka humbje të cilën e bartë duke u bazuar në legjislacionin vijues. Humbja mund të bartet për 6 (gjashtë) vitet e ardhshme nga momenti i paraqitjes së humbjes.

#### 17. REZERVAT REVALORIZUESE

	2019	2018
Rezervat revalorizuese më 31.12.2019	<u>14,198,816</u>	<u>8,989,997</u>
	14,198,816	8,989,997

Rezervat revalorizuese janë të paraqitura në bilancin egjendjes në shenimin 17. Këto rezerva burojnë nga rivlersimi i pronës në vitin 2018 si dhe rezervat K.A 5,226,141. Një pjesë e tyre nëpërmes të zhvlersimit do të zvoglohet prej vitit në vit, ndërsa toka mbetet e pa ndryshuar dhe kap vlerën prej 14,198,816€.

**Instrumentet financiare.** - Instrumentet financiare kryesore të ndërmarrjes, përveç borxhlinjve tregtarë dhe kreditorë tregtarë, rrjedhin nga operacionet e saja të zakonshme, duke përfshirë paranë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme.

**Vlera fer e instrumenteve financiare.** - Instrumentet financiare të cilat janë të paraqitura në bilancin e gjendjes përfshijnë paratë e gatshme në arkë dhe në bankë, të arkëtueshmet dhe pagueshmet. Vlera bartëse e këtyre instrumenteve financiare është e përafërt me vlerën e tyre reale. Vlera reale-fer është ajo shumë e cila mund të ndërrohet në mes të dy palëve me vetëdije të plotë dhe me dëshirën e palëve me një transaksion në gjatësinë e krahut.

**Tatimi në të ardhura.** - Tatimi në të ardhura paraqet shumën e tatimit e cila është e pagueshme dhe tatimin e përlogaritur. Tatimi i cili llogaritet dhe paguhet në pajtim me Ligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, Ligji Nr.05/L-29. Tarifa për tatimi në fitim të korporatave është 10%, duke u bazuar në fitimin vjetor të rregulluar për njësitë, të cilat janë të matshme. Firma ka humbje të cilën e bartë duke u bazuar në legjislacionin vijues humbja mund të bartet për 6 (gjashtë) vitet e ardhshme nga momenti i paraqitjes së humbjes.

Po ashti ndërmarrja zbaton edhe : Ligji Nr.05/L-28 Për Tatimin në të Ardhura personale si dhe Ligji Nr.05/L-37 Tatimi në Vlerën e Shtuar.

**Tatimi në qira.** - Tatimi në qira prej 9% është llogaritur dhe është ndalë në Burim nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe disa kompanive të tjera që njihen si persona Juridik dhe që nga 01.09.2015 edhe kompanitë e tjera të cilët janë në cilësinë e qeramarrjes e ndalin tatimin e qirasë në burim dhe të njëjtit kanë për obligim që në fund të vitit ta dëshmojë pagesën e tatimit në burim të qirasë nëpër mes të certifikatës standard të përcaktuar nga ana e ATK-s. Kjo vlerë nuk është bërë kërkesë për rimbursim por është evidentuar si kërkesa ndaj ATK-ës dhe kompania ka vendos që në të ardhmen të shërben për shlyerjen e obligimeve vijuese ndaj ATK-ës.

**Detyrimet kontigjente.** – Ndërmarrja është e paditur nga disa puntorë të stacionit në gjykatë si më poshtë:

Detyrimet kontigjente/Lenda	Data	Arsyeja e Detyrimet/Koment	Paditesi	Shkallshmeria
02/1259	31.07.2019	Përgjigje në padi C.nr.1514/19	Adonis Shabani	Gjykate themelore
02/25611	31.07.2019	Ankesë për Gjykatë të Apelit C.nr.2561/18	Isuf Maliqi	Gjykate te Apelit
02/957	25.06.2019	Ankesë për Gjykatë të Ap. C.nr.2559/18	Elez Gashi	Gjykate te Apelit
02/986	25.06.2019	Aktgjykim refuzues nga Gjykata Th.C.nr.2558/18	Mustafë Doda	Gjykate themelore
02/761	27.05.2019	Ankesë për Gjykatë të Ap.C.nr.	Mustafë Selimi	Gjykate te Apelit
02/653	13.05.2019	Ankesë për Gjykatë të Ap. C.nr.2549/19	Sami Ahmeti	Gjykate te Apelit
02/2367	18.12.2019	Ankesë për Gjykatë të Ap. C.nr.1252/19	Sami Ahmeti	Gjykate te Apelit
02/ 2406	24.12.2019	Përgjigje në padi C.nr.2487/18	Mihrie Rexha	Gjykate themelore

**Parimi i vazhdimësisë.** - Edhe pse kompania për vite ka afaruar me rezultate negative në Pasqyra financiare , po ashtu ne vitin 2019, kompania ka përmbyll vitin afarist me humbje e cila pasqyrohet në pasqyra financiare.

#### **19.Ngjarjet pasuese**

Përveç siç është ceket më lartë, asnjë ngjarje ose transaksion tjetër nuk ka ndodhur ose nuk janë në pritje që nga 31 dhjetori 2019 të cilat do të kishin një efekt material në pasqyrat financiare të ndërmarrjes në atë datë ose për periudhën e përfunduar më pas, apo që kanë një rëndësi të tillë në lidhje me çështjet e Ndërmarrjes për tu përshkruar në një shënim të pasqyrave financiare.

ZKFTH: Arianit Grezda  
Punoi: Emin Sylejmani  
Pozita: Udhëheqës i Kontabilitetit

Aprovoi: Luan Hoti  
KE i NPL"Stacioni i Autobusëve"Sh.A